

1 E premte, 2 dhjetor 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [Seanca e apelit]

4 [Apeluesit hynë në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 9.30 paradite

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Mirë se
7 erdhët përsëri në seancën e apelit.

8 A mund t'ju kërkoj palëve, ju lutem, që të prezantohen?

9 Vërej se z. Haradinaj dhe z. Gucati janë të pranishëm të
10 dy në sallën e gjyqit.

11 Dhe sikurse e bëmë edhe dje, dua t'i kërkoj z. Haradinaj
12 në qoftë se ai i kupton proceset gjyqësore në një gjuhë që ai
13 e kupton? A mund ta ndiqni procesin në një gjuhë që e kuptoni?

14 APELUESI HARADINAJ: Po, e kuptoj.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Z. Gucati,
16 po juve?

17 APELUESI GUCATI: Po, e kuptoj.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Atëherë
19 fillojmë me Mbrojtjen e z. Gucati.

20 A mund t'i kërkoj Sekretares të thërrasë çështjen?

21 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuara
22 Gjykatëse. Kjo është çështja KSC-CA-2022-01, Prokurori i
23 Specializuar kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

25 Faleminderit.

1 Z. Avokat i z. Gucati, ju lutem prezantohuni.

2 Z. REES: [Përkthim] A mund të them që ne jemi në të
3 njëjtën përbërje siç kemi qenë dhe dje. Më lejoni të them
4 diçka lidhur me z. Gucati. Mund të ndodhë që z. Gucati të
5 ngrihet në këmbë sepse është e nevojshme që të ngrihet në
6 këmbë. Kështu që, ju lutem, kiheni parasysh këtë gjë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Po e vura
8 re dhe dje nga ekrani që herë pas here z. Gucati u ngrit në
9 këmbë.

10 Avokatja për z. Haradinaj.

11 ZNJ. BERNABEU: [Përkthim] Faleminderit. Kemi z. Cadman që
12 është i lidhur me ne në distancë sot. Kemi z. Admir Berisha
13 dhe kemi dhe z. Omar Soliman.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Z. Cadman,
15 uroj që të jeni bërë më mirë.

16 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Më ngadalë.
17 Faleminderit që më pyetët, e nderuar Gjykatëse.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Për
19 Prokurorinë.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Ne kemi të njëjtën përbërje siç
21 kishim edhe dje.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
23 Faleminderit.

24 Edhe ne jemi të njëjtët siç kemi qenë edhe dje. Unë jam
25 Michele Picard, kemi gjyqtarin Kai Ambos dhe Gjyqtaren Nina

1 Jorgensen.

2 Sot do të fillojmë me parashtrimet e Prokurorisë.

3 Z. WHITING: [Përkthim] Mirëmëngjes të gjithëve. Unë jam
4 Alex Whiting. Unë jam Prokuror i Specializuar në detyrë.

5 Pas pak, z. Halling dhe z. Pace do të trajtojnë çështje
6 specifike të cilat u ngritën nga Mbrojtja e të akuzuarve dje.
7 Megjithatë, përpara sesa ta marrin ata fjalën, dëshiroj që të
8 jap një kuadër të përgjithshëm kësaj çështjeje dhe apelit dhe
9 disa prej gjërave të cilat u identifikuan dje. Dua ta informoj
10 Gjykatën për të gjitha gjërat që ndodhën dje dhe që na çuan në
11 pikën që jemi sot. Pra, dua të flas për sjelljen e të
12 akuzuarit edhe proceset gjyqësore përpara Trupit Gjykues që
13 çuan në shpalljen e tyre fajtorë.

14 Të akuzuarit pretendojnë që janë trajtuar në mënyrë të
15 padrejtë në proceset gjyqësore më poshtë. Asgjë nuk mund të
16 jetë më larg të vërtetës. Nuk ka asnjë pyetje, as një
17 pikëpyetje që të akuzuarit kanë kryer krimet për të cilët ata
18 janë akuzuar dhe që kanë pasur mundësi të plotë që të
19 kundërshtojnë çështjen e paraqitur nga Prokuroria. Ata janë
20 dënuar pas një procesi gjyqësor tërësisht të drejtë dhe dënimi
21 i dhënë prej tyre ka qenë i drejtë.

22 Në tre raste të veçanta - më datën 7, 16 dhe 22 shtator
23 të vitit 2020 - të akuzuarit kanë organizuar konferenca për
24 shtyp në Shoqatën e Veteranëve të Luftës, në selinë e kësaj
25 shoqate në Prishtinë dhe duke e ditur dhe me dashje kanë

1 shpërndarë dokumente konfidenciale të lidhura me hetimet e
2 ZPS-së për median, duke inkurajuar shtypin që të botojë
3 materialet.

4 Pas secilës konference për shtyp, të akuzuarit e kanë
5 zmadhuar më tej sjelljen e tyre duke folur me median dhe duke
6 bërë postime në median sociale. Përmes kësaj sjelljeje të
7 akuzuarit kanë kryer krimet --

8 Z. REES: [Përkthim] Nuk dua që të ndaloj z. Whiting, por
9 ky nuk është proces gjyqësor, siç e thatë dhe ju, të nderuar
10 Gjykatës. Ky është apel. Kështu që jam pak i hutuar çfarë do
11 të thotë z. Whiting ndërkohë që po bën komente sikur po
12 mbyllet çështja.

13 Z. WHITING: [Përkthim] Z. Rees, unë e shpjegoj.
14 Domethënë, ju kemi kontestuar të gjitha pretendimet dhe
15 drejtësinë e procesit gjyqësor. Dhe për këtë arsye, unë,
16 thjesht, po bëj një panoramë të përgjithshme të çështjes dhe
17 pastaj pikat specifike do të trajtohen nga kolegët e mi.

18 Çdo gjë që unë po them tani lidhet me argumentet që
19 ngritët ju dhe z. Cadman dje.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Dua t'i
21 kërkoj palëve që të mbarojnë me këtë diskutim. Mendoj që
22 Prokuroria ka të drejtë që të flasë. Në qoftë se do që të bëjë
23 një panoramë, do ta kujtojë Gjykatën për atë çfarë ka ndodhur,
24 është e drejta e Prokurorisë ta bëjë këtë gjë. Ndërkohë që
25 Prokuroria ka dy orë për ta bërë këtë gjë, pra, për ta

1 paraqitur çështjen e vetë në apel.

2 Z. WHITING: [Përkthim] Përmes kësaj sjelljeje të
3 akuzuarit i kanë kryer krimet për të cilat janë dënuar nga
4 Trupi Gjykses. Ata këtë gjë e kanë bërë në mënyrë të hapur në
5 televizion dhe në media. Të nderuar Gjykatës, juve mund t'i
6 shikoni të akuzuarit që e kanë kryer krimin ndërkohë që janë
7 regjistruar në video.

8 Pas konferencës së shtypit, ZPS-ja vijoi shpejt që të
9 sekuestronte dokumentet dhe të akuzuarit u urdhëruan nga
10 Gjykatësi i Vetëm i kësaj Gjykate që të ndalonin shpërndarjen
11 e dokumenteve. E bënë këtë gjë të akuzuarit? Jo, nuk e bënë.

12 Pasi u lajmëruan nga ZPS-ja, pavarësisht nga lajmërimet,
13 ata vazhduan që të shpërndanin informacion konfidencial.

14 Edhe pa herës së tretë - hera e tretë, e theksoj - ZPS-
15 ja, pra, lëshoi urdhër-arrestime dhe të akuzuarit u arrestuan
16 në Prishtinë dhe u sollën në Hagë ku akuzuan për krimet që
17 janë objekt i këtyre procedimeve gjyqësore, krime të cilat të
18 akuzuarit i kanë kryer drejtpërsëdrejti në televizion.

19 Të akuzuarit nuk u shpallën fajtor, siç është e drejta e
20 tyre dhe insistuan që Prokuroria të provonte përgjegjësinë
21 penale përtej dyshimit të arsyeshëm, siç është e drejta e tyre
22 po ashtu dhe këtë ka bërë Prokuroria. Mbi bazën e të gjithë
23 fajit që ishte i pranishëm, Trupi Gjykses konstatoi që
24 Prokuroria kishte provuar përtej dyshimit të arsyeshëm çdo
25 element që lidhet me pesë nga gjashtë pikat e aktakuzës.

1 Në çdo fazë të proceseve gjyqësore, të drejtat e të
2 akuzuarve dhe aftësia e tyre për të ngritur kundërshtime për
3 fakte juridike dhe ligjore janë mbrojtur plotësisht nga
4 Gjykatësi i Procedurës Paraprake, nga Trupi Gjykues dhe nga
5 Paneli i Trupit Gjykues. Të akuzuarit janë lejuar që të
6 kundërshtojnë mbajtjen e tyre në burgim, duke përfshirë këtu
7 edhe përpara Gjykatës, nëntë herë të veçanta. Ata kanë marrë
8 të gjitha materialet e nxjerra të lidhura me aktakuzën. Dhe
9 dua të them që ata gjithashtu kanë marrë të gjithë dokumentet
10 të cilat kanë të bëjnë me pretendimin e Mbrojtjes për shtytjen
11 në kryerjen e krimit dhe, ndërkohë që nuk kanë ofruar asgjë në
12 mbrojtje të tyre.

13 Mbrojtja është lejuar që të kundërshtojë çdo aspekt të
14 procesit gjyqësor në çështjen e ngritur ndaj tyre. Gjatë
15 procesit gjyqësor, Mbrojtja ka pasur mundësi që të
16 kundërshtojë provat e Prokurorisë e të marrë në pyetje
17 dëshmitarët e Prokurorisë dhe gjithashtu edhe të marrë dhe të
18 paraqesë 13 dëshmitarë të vetët.

19 Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, së pari, dua t'i
20 kujtoj z. Whiting atë çfarë thatë ju dje. Në fakt, urdhëruat,
21 dje, që palët nuk duhet të përsërisin provat e tyre ose
22 pozicionin e tyre.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Në qoftë se
24 nuk flisni përpara mikrofonit nuk ju dëgjojnë përkthyesit.

25 Z. REES: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Juve dje urdhëruat

1 me gojë që të mos përsërisim gjëra që i kemi thënë gjatë
2 procesit gjyqësor, nuk e keni lënë në dorë të palëve këtë gjë.

3 E dyta gjë që dua të them është se z. Whiting sapo e
4 çorientoi Gjykatën dhe ata që dëgjojnë këto procese gjyqësore
5 kur tha që të akuzuarit kanë marrë të gjithë dokumentet të
6 cilat lidhen me pretendimin që ka të bëjë me shtytjen në
7 kryerjen e veprës penale.

8 Dhe, në fakt, nuk është kështu. Dokumentet, të cilat kanë
9 të bëjnë me këtë pretendim të Mbrojtjes, nuk janë marrë gjatë
10 procesit gjyqësor. Kemi marrë vetëm thjesht ca dokumente pas
11 procesit gjyqësor.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Ju dëgjuam
13 dje, i dëgjuam parashtrimet tuaja dje lidhur me nxjerrjen e
14 dokumenteve, jemi të informuar, lidhet me parashtrimet, kështu
15 që e dimë qëndrimin tuaj.

16 Z. REES: [Përkthim] Në qoftë se z. Whiting do të thotë
17 gjëra fakti, atëherë dua që të jetë i saktë. Sapo e çorientoi
18 Gjykatën, Trupin Gjyqësor dhe ata të cilët dëgjojnë procesin
19 gjyqësor. Ndërkohë, që ne e dimë që, në fakt, materialet janë
20 nxjerrë, materialet që kanë të bëjnë me pretendimin e
21 Mbrojtjes për shtytje në veprën penale janë nxjerrë vetëm pas
22 përfundimit të çështjes.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Mbajtëm
24 shënim parashtrimet tuaja. Por, siç e thashë edhe më përpara,
25 ju dëgjuam dje plotësisht dhe jemi në dijeni të asaj çfarë

1 kemi paraqitur në dosjen tuaj.

2 Ju kërkoj që të vazhdoni më tej, z. Prokuror.

3 Z. WHITING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

4 Për procesverbal, më lejoni të them, se çdo gjë që po
5 them në fjalën time është absolutisht e vërtetë. Dhe Mbrojtja
6 e di këtë gjë shumë mirë.

7 Z. REES: [Përkthim] Nuk është e vërtetë.

8 Z. WHITING: [Përkthim] Ne nuk ju ndërpreme fare dje
9 pavarësisht kohës që morët, pavarësisht se ishit më i gjatë se
10 ç'kishit kohë.

11 Të akuzuarit u ankuan që Prokuroria duhet t'i kishte
12 dhënë atyre tërësinë e paketave me informacione të cilat ishin
13 sekuestruar prej tyre pasi ato jua kishin dhënë këto paketa
14 medias. Ky argument është i gabuar dhe është absurd. Pozicioni
15 i Mbrojtjes është që e vetmja mënyrë që të gjykohet kjo
16 çështje është që të akuzuarve t'u kthehen dokumentet shumë
17 konfidenciale dhe të ndjeshme, përfshirë këtu dhe produktin e
18 brendshëm të punës që të akuzuarit ja shpërndanë publikut, një
19 krim të cilët ata kanë thënë në mënyrë të përsëritur se do ta
20 bënin prapë.

21 Gjykatësi i Vetëm dhe Trupi Gjykses me të drejtë
22 konstatuan që ka arsye bindëse, arsye bindëse të dukshme, për
23 mosdorëzimin e paketave që janë sekuestruar nga vetë të
24 akuzuarit të cilët i kanë shpërndarë këto materiale dhe ata
25 kanë vënë masa kompensuese për të siguruar që Mbrojtja do të

1 kishte informacion të plotë, të mjaftueshëm sa i takon
2 përmbajtjes së dokumenteve për t'i testuar ato. Dhe këtë bënë.
3 Pavarësisht përmbajtjes së paketave, së pari, çështja ka
4 të bëjë me faktin në qoftë se ato lidhen me hetimet e ZPS-së;
5 së dyti, në qoftë se ato janë konfidenciale; dhe, së treti, në
6 qoftë se ato kanë emrat e dëshmitarëve të mbrojtur. Janë
7 pikërisht këto tre fakte të cilët mund të vërtetohen
8 mbështetur në faqet e paketave që, në fakt, janë nxjerrë për
9 të akuzuarit.

10 Le të bëjmë një pauzë të shkurtër këtu për një moment.
11 Tri fakte të cilat kanë të bëjnë me përmbajtjen e paketave
12 janë vërtetuar përtej çdo dyshimi nga faqet të cilat janë
13 nxjerrë të akuzuarit. Përveç kësaj, keni edhe përshkrimet e të
14 akuzuarve mbi paketat, sepse, sigurisht, ata i kanë parë dhe i
15 kanë studiuar çfarë kishin këto paketa, kemi gjithashtu edhe
16 dëshminë e të akuzuarve në gjykim, raportimin në media sa i
17 takon paketave me dokumente, dëshminë e Dëshmitarit 4866 dhe
18 tabelën e hollësishme dhe provat të cilat janë dhënë nga
19 Dëshmitari i Prokurorisë 4841.

20 Le të jemi të qartë këtu. Mbrojtja ka qenë plotësisht në
21 gjendje që të kundërshtojë dhe të testojë përmbajtjen dhe
22 vërtetësinë e paketave me informacion dhe ka prova të qarta
23 dhe të patjetërsueshme në procesverbal që mbështet konstatimet
24 e Trupit Gjykues.

25 Për shkak se nuk kishte pikë dyshimi rreth asaj çfarë

1 kanë bërë të akuzuarit në këtë çështje, Mbrojtja iu drejtua
2 mbrojtjes së shtytjes në veprën penale dhe justifikimit që ka
3 të bëjë me interesin publik. Të dyja këto pista mbrojtjeje
4 çuan në asgjë. Thjesht nuk ekziston asnjë lloj baze për asnjë
5 nga Mbrojtjet. Dhe tani që faktet i kemi të gjitha përpara
6 dhe faktet janë vlerësuar, ne mund të themi qartësisht atë
7 çfarë ka qenë e qartë gjatë gjithë procesit, që këto dy
8 mbrojtje ishin dhe aktualisht janë, pra, këto dy pista për
9 Mbrojtjen janë në aspektin ligjor dhe në aspektin faktik pa
10 meritë.

11 Përmes procesit gjyqësor dhe deri më sot, Mbrojtja ka
12 pretenduar shtytjen në kryerjen e veprës penale. Megjithëse
13 asnjë fakt nuk ka mbështetur këtë pretendim të Mbrojtjes dhe
14 çdo gjë që kanë bërë dhe kanë thënë të akuzuarit, përfshirë
15 këtu edhe dëshminë që ata kanë dhënë në procesin gjyqësor, në
16 fakt, janë në kundërshtim, bien ndesh me këtë mbrojtje, me
17 këtë pistë për mbrojtje. Siç u konstatua nga Trupi Gjykses në
18 paragrafin 836 të aktgjykimit, shtytja në veprën penale ndodh
19 atëherë kur zbatimi i ligjit "ushtron një ndikim të tillë mbi
20 subjektin për të nxitur kryerjen e një vepre e cila nuk do të
21 ishte kryer ndryshe", ky është fundi i citimit.

22 Ne e dimë me siguri - e dimë me siguri - që kjo nuk ka
23 ndodhur. Edhe kjo trajton atë çfarë qëndron në thelb të
24 pyetjes së gjykatësit Jorgenson dhe që pyeti se cilat janë
25 provat që ekzistojnë, që tregojnë nxitje ose detyrim.

1 Përgjigja për këtë pyetje është "asnjë". Nuk kishte asnjë lloj
2 prove në mbështetje të këtij pretendimi.

3 Për një moment le ta lëmë mënjanë faktin sesi përfunduan
4 paketat tek të akuzuarit. Kësaj çështjeje do t'i kthehem pak
5 më vonë. Megjithatë, ne e dimë me siguri që të akuzuarit nuk
6 janë detyruar në asnjë mënyrë për të kryer krimet që kanë
7 kryer në konferencat për shtyp. Në çdo fazë - ndërkohë që kanë
8 kryer krimet, më pas dhe madje edhe gjatë procesit të gjykimit
9 - të akuzuarit kanë pranuar dhe kanë vlerësuar atë çfarë kanë
10 bërë.

11 Ata nuk janë detyruar për ta bërë këtë gjë. Z. Gucati tha
12 se askush, përveç Zotit, nuk mund ta detyronte atë që të
13 thërriste tri konferencat për shtyp. Ata vazhduan që ta bënë
14 këtë gjë dhe e kanë thënë që do ta bënë prapë në qoftë se do
15 ju vinte rasti. Kjo në vetvete është e mjaftueshme që të
16 rrëzohet pista e shtytjes në kryerjen e veprës penale për të
17 akuzuarit.

18 Por, është gjithashtu e vërtetë që paketat me informacion
19 nuk i kanë dhënë nëpunësit e zbatimit të ligjit. Sigurisht që
20 nuk ka ndodhur kjo gjë. Në paragrafët 859, 890 të aktgjykimit,
21 pra, paragrafë të cilët nuk u përmendën nga Mbrojtjet, në
22 mënyrë metodologjike, Trupi Gjykses trajtoi dhe rrëzoi secilën
23 prej argumenteve të paraqitura nga Mbrojtja, duke identifikuar
24 që nuk ka pasur asnjë provë për sa i takon përfshirjes së
25 nëpunësve të zbatimit të ligjit.

1 GJYKATËSJA JORGENSEN: [Përkthim] Z. Whiting, në qoftë se
2 mund të të bëj një pyetje lidhur me këtë prag që nuk është
3 tërësisht i pamundur, z. Rees e shpjegoi pozicionin e
4 Mbrojtjes që nuk ka një barrë provuese për shkak të këtij
5 argumenti. Nuk e di në qoftë se mund ta trajtoni këtë element
6 dhe në qoftë se mund të na shpjegoni pak më qartë se cila
7 është kjo barrë dhe si demonstrohet ajo, sepse juve gjithashtu
8 ju referuat pistës së shtytjes në kryerjen e veprës penale të
9 përdorur nga Mbrojtja.

10 Z. WHITING: [Përkthim] Faleminderit. Ndonjëherë i
11 referohemi kësaj si shtytje në kryerjen e veprës, megjithatë,
12 Trupi Gjykses ju referua kësaj si mekanizëm procedural që ka
13 të bëjë me drejtësinë e procesit.

14 Në përgjigje të argumentit, në qoftë se bëhet fjalë për
15 një standard tërësisht i pamundur, ky nuk është një test
16 provues, kjo është një gjë komplet e gabuar. Ajo çfarë do të
17 nevojitej në këtë rast, po të ishte kështu, do ishte që të
18 ndaluarit, të akuzuarit të mund të përmendnin fjalën "shtytje"
19 në kryerjen e veprës vetë, pra, siç u tha edhe nga Mbrojtja,
20 pretendimi është i mjaftueshëm. Dhe për aq kohë sa pretendimi,
21 në pamje të parë, ishte koherent, atëherë Prokuroria duhej që
22 të provojë të kundërtën për të rrëzuar pozicionin e Mbrojtjes.

23 Pra, kjo është një barrë provuese. Nuk është
24 domosdoshmërisht, domethënë, një barrë provuese e lartë, por
25 mund të testohet përmes provave. Dhe Mbrojtja shprehimisht e

1 pranoi këtë në Gjykatë, sepse u munduan që të kërkonin prova
2 përmes ndërhyrjes.

3 Megjithatë, edhe dje, në fakt, Mbrojtja u mundua që të
4 ofronte prova, domethënë, pavarësisht që neve pretenduam të
5 kundërtën, pra, ai u mundua që të thoshte që z. Gucati kishte
6 ofruar prova, numri një, duke argumentuar se për shkak të
7 faktit që paketat i ishin dhënë atij, ai pati mundësinë që të
8 kryente krimin. Kjo nuk është e mjaftueshme që të përmbushet
9 standardi, sepse kjo do të ishte e vërtetë për çdo çështje.
10 Nuk është vetëm thjesht mundësia. Nuk është një test që duhet
11 të bëhet diçka që të çojë në diçka tjetër.

12 Dhe u rekomandua, gjithashtu, që në rastin e ofrimit të
13 paketës së parë, personi që kishte dhënë, kishte çuar paketën,
14 nuk mund t'i them ekzaktësisht, por kishte thënë pak a shumë
15 që "duhet t'ia jepni medias -- jepni medias këto materiale".
16 Kjo është e pamjaftueshme për të treguar nxitje ose për të
17 treguar shtytje në kryerjen e veprës penale. Pra, duhet të
18 ketë një lloj pragu minimal prove që tregon detyrim ose që
19 tregon shtytje në veprën penale.

20 Dhe këtu, nuk kemi vetëm thjesht mungesën e këtyre
21 provave, por të gjitha provat që janë paraqitur, përfshirë dhe
22 provat e Mbrojtjes, shkojnë në drejtim tjetër, të kundërt. Që
23 tregojnë që ata nuk janë detyruar fare. Pra, dy të akuzuarit
24 nuk janë detyruar por ata kanë thënë, në fakt, me fjalët e
25 veta që ata kanë vijuar me shpërndarjen e materialeve. Këtë

1 gjë e kanë dëshmuar dhe përpara Trupit Gjykses dhe thanë që
2 askush tjetër për veç Zotit, për shembull, nuk mund të më
3 detyronte mua që të mblidhja konferencat për shtyp.

4 Shpresoj që ju përgjigja pyetjes tuaj, e nderuara
5 Gjykatëse.

6 GJYKATËSJA JORGENSEN: [Përkthim] Faleminderit.

7 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] A mund të bëj një pyetje
8 tjetër plotësuese ndaj pyetjes që bëri kolegja? Jurisprudenca
9 për të drejtat e njeriut, pra, çështjet e GJEDNJ-së prezumojnë
10 që në rastet e nxitjes për kryerjen e krimin, pra, ka
11 përfshirje të policisë, të nëpunësve të policisë. Të gjitha
12 çështjet e GJEDNJ-së flasin për këtë skenar pak a shumë. Nuk
13 është rasti ky këtu në këtë çështje.

14 Pyetja që kam për ju është cila është pasoja e këtij
15 ndryshimi faktik, se, për shembull, në rastet që përfshin
16 nenin 6 të Konventës, kemi rastin kur punonjësit e policisë
17 nxisin dikë që të kryejë një vepër penale, ndërkohë që në
18 rastin në fjalë, në çështjen në fjalë, nuk jemi në dijeni të
19 përfshirjes së askujt të policisë. Kështu që, a bën ndonjë
20 dallim kjo sa i takon standardit që rrjedh nga neni 6 i KEDNJ-
21 së?

22 Z. WHITING: [Përkthim] Ne kemi argumentuar gjatë gjithë
23 kohës që kemi dy linja, pista të standardit. Domethënë, e para
24 ka të bëjë me përfshirjen e nëpunësve të zbatimit të ligjit;
25 dhe së dyti ka të bëjë me detyrimin ose nxitjen e kryerjes së

1 veprës. I kemi trajtuar këto edhe në aktakuzë në fakt.

2 Pra, sipas pikëpamjes tonë, asnjë prej këtyre pikave apo
3 pistave nuk është e zbatueshme. Është e pamundur kjo gjë nga
4 fillimi deri në fund. Pra, nuk qëndron pretendimi i Mbrojtjes
5 që ka pasur shtytje të të akuzuarve për kryerjen e veprës
6 penale sepse, së pari, nuk kishte përfshirje të nëpunësve të
7 zbatimit të ligjit dhe, së dyti, nuk ka pasur detyrim për
8 kryerjen e krimit.

9 Në qoftë se Paneli i Apelit, pra, arrin në përfundimin që
10 nuk ka detyrim, siç ka bërë Trupi Gjykses, atëherë këtu i vjen
11 fundi çështjes dhe nuk ka nevojë që të bëhen kërkesa të tjera.

12 Pra, provat tregojnë që nuk pasur detyrim, nuk ka pasur
13 shtytje për kryerjen e veprës penale dhe për pasojë nuk arsye
14 që të vinim në apel.

15 Mbrojtja për interesin publik është në të njëjtën linjë,
16 nuk është më mirë sesa çfarë thashë më sipër. Mbrojtja
17 pretendon që të akuzuarit po kërkonin që të tregonin që
18 Prokuroria ka bashkëpunuar me Serbinë. Kjo është e rreme.
19 Sjellja e deklaratave të të akuzuarit tregojnë padyshim që
20 objektivi i tyre ishte që të minonte punën e këtij
21 institucioni dhe që të shkaktonin kolapsimin e saj dhe jo
22 vetëm kaq por, gjithashtu edhe që të frikësonin dëshmitarët
23 dhe dëshmitarët e mundshëm.

24 Dhe kjo në vetvete si pistë e Mbrojtjes dështon
25 tërësisht.

1 Në fund të ditës, kjo është një çështje e thjeshtë dhe e
2 drejtpërdrejtë edhe pse është shumë e rëndë. Të akuzuarit i
3 kanë kryer krimet për të cilat janë akuzuar. E kanë bërë këtë
4 gjë në dritën e diellit. Vazhdojnë që t'i qëndrojnë kauzës së
5 vetë. Nuk kanë pikë keqardhje për atë çfarë ka ndodhur. Nuk
6 janë -- dhe thonë që do t'i kryer këto krime në qoftë se do të
7 kishin mundësi në të ardhmen.

8 Për shkak të pasojave të akteve të tyre dhe motivimeve të
9 deklaruar, dënimi me katër vite e gjysëm heqje lirie është i
10 justifikuar dhe është edhe i drejtë. Pjesë e arsyes sepse
11 është krijuar kjo Gjykatë dhe e ka selinë në Hagë është që të
12 luftojnë përpjekjet për frikësimin e dëshmitarëve dhe cenimin
13 e Gjykatës dhe kjo ka të bëjë me sjelljen e të akuzuarve në
14 këtë çështje. Ne parashtrojmë se kjo çështje ka treguar që kjo
15 Gjykatë ka realizuar një proces ligjor, të drejtë, plotësisht
16 mbrojtës së të drejtave të të akuzuarve dhe të shpejtë.

17 Mbi këtë bazë, të nderuar Gjykatës, neve ju kërkojmë që
18 të lini në fuqi dënimet e dhëna nga Trupi Gjykues dhe tani do
19 t'ua jap fjalën kolegëve të mi, së pari z. Halling, për të
20 ngritur çështje të cilat janë ngritur më në detaje dhe nga
21 Mbrojtjet.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

23 Faleminderit.

24 Z. Halling.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Unë dhe z. Pace do të trajtojmë në

1 hollësi argumentet e ngritura nga Mbrojtja.

2 I kemi ndarë temat ndërmjet nesh si më poshtë: Unë do të
3 mbështetem në arsyet e apelit të lidhura me dënimet e gjetura
4 në aktgjykimin, të tilla si, për shembull, ligji i zbatueshëm,
5 konstatimet faktike, gjithashtu edhe pistat e Mbrojtjes për të
6 akuzuarit. Ndërkohë që z. Pace do të merret me arsyet që kanë
7 të bëjnë kryesisht me nxjerrjen e informacionit si dhe me
8 dënimet e marra.

9 Gjatë të gjithë këtij procesi gjyqësor, Mbrojtja ka dhënë
10 argumente të cilat nuk kanë qenë të pranishme në këtë çështje.
11 Ata kanë prezantuar interpretime ligjore të kufizuara të
12 dispozitave ligjore të cilat nuk janë parë në këtë dritë nga
13 asnjë prej gjyqtarëve që i ka lexuar këto dispozita. Kanë
14 dhënë gjithashtu edhe nënkuptime të cilat nuk janë fare të
15 mbështetura nga provat. Unë dua të them që në fillim që, pra,
16 aktgjykimi që është objekt i shqyrtimit tuaj, të nderuar
17 Gjykatës të apelit, është tërësisht i bazuar, i arsyetuar dhe
18 i mbështetur në të njëjtat pika që atakohen nga Mbrojtja.

19 Mbrojtja vazhdon në taktikat e veta, e ka bërë dhe dje.
20 Kështu që, ne mund të fillojmë me krimin dhe ku kanë filluar
21 ata, sa i takon frikësimit. Do të fillojmë në veçanti me
22 teorinë me tre alternativa, ku gjuha në nenin 378 të Kodit
23 Penal të Kosovës kuptohet sikur modifikon ose ndryshon të
24 gjitha tri alternativat në parashikimin ligjor dhe, në fakt, e
25 vërteta është që përcakton vetëm alternativën e tretë.

1 Pra, disa prej këtyre arsyesh janë diskutuar në pyetjet e
2 bëra nga gjykatësi Ambos, nga cilësimi i informacionit dhe ky
3 informacion është dhënë dhe, në fakt, besoj që ka qenë e qartë
4 që përdorimi i fjalës "i vërtetë" nuk ka të bëjë ose nuk
5 sugjeron domosdoshmërisht vërtetësinë ose jo të kësaj
6 alternative.

7 Të gjithë neve, në fakt, dëgjuam për nenin 310 të Kodit
8 të Përkohshëm. Pamë gjithashtu që kemi të bëjmë thjesht me një
9 ndryshim të këtij neni ndërmjet krimit të organizuar dhe të
10 çështjes ku jemi aktualisht.

11 Dhe këtu e kam fjalën për ndryshim që shpjegoi Mbrojtja
12 ndërmjet nenit 310 të Kodit të Përkohshëm dhe nenit 387.

13 Ndërkohë, neni 310 në titullin e vet thotë, "Frikësim
14 gjatë procedurave penale dhe krimi i organizuar". Dhe ky është
15 një nen i cili nuk i drejtohet "pengimit të proceseve
16 gjyqësore".

17 Pra, ne nuk mund ta dimë se çfarë kanë pasur në mend
18 hartuesit, ndryshe siç u shpreh nga Mbrojtja e z. Gucati.
19 Megjithëse, në përgjigje të pyetjes së Gjykatësit edhe ai tha
20 që nuk e dinte se çfarë kishin në mendje hartuesit e aktit
21 ligjor. Megjithatë, ndryshimi i një instrumenti ligjor mund të
22 jetë tregues i synimit legjislativ. Dhe, në rastin në fjalë,
23 duhet që të bëhet interpretimi më i gjerë në momentin aktual
24 sesa ç'është bërë në Kodin Penal të Përkohshëm.

25 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Ku është rëndësia e titujve

1 për këtë dispozitë?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Është një tregues për qëllimin e
3 kësaj dispozite. Është një --

4 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] A e dimë ne që këto tituj
5 janë pjesë të dispozitës? Sepse në të drejtën gjermane, titujt
6 nuk janë pjesë e dispozitës. Nuk jam i sigurt. Është vërtetë
7 një pyetje kjo. A është pjesë e dispozitës? Kush ja vendosi
8 titullin kësaj dispozite në të drejtën kosovare?

9 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, ne nuk e dimë sesi vendosen
10 këta titujt. Ne, thjesht, po themi që ka ndryshuar dhe në të
11 vërtetë ne nga kjo e marrim kuptimin. Dhe themi që mungon një
12 tërësi e interpretimit nga Mbrojtja e Gucatit sa i takon
13 jurisprudencës që të mbështesë interpretimin ekzistues të
14 kësaj dispozite.

15 Ne kemi autoritet, kemi kompetencë, që alternativa e
16 tretë që mbulon këto teza nuk ndiqet, në fakt, nga gjykatat e
17 Kosovës. Ju kemi dhënë dy autoritete. Janë në Shtojcën 2, të
18 përkthyer në anglishte.

19 Nëse frikësimi çon në shpalljen e fajësisë, sipas nenit
20 387, nëse do kishte vepër penale mëmë të pengimit të
21 drejtësisë, aktgjykimet që kemi prezantuar ne, që nuk kanë
22 asnjë lidhje me këtë, atëherë nuk duhet të ekzistojnë.

23 Mbrojtja e Gucati dhe të dyja ekipet e Mbrojtjes në fakt, në
24 mënyrë të vazhdueshme kanë argumentuar gjatë procesit dhe në
25 apelin e tyre se kjo Gjykatë nuk ka respektuar mjaftueshëm të

1 drejtën kosovare dhe jurisprudencën kosovare.

2 Po ku jemi ne këtu? E gjithë jurisprudenca e Kosovës nuk
3 është në anën e tyre dhe vazhdojnë e këmbëngulin edhe i ngrenë
4 argumentet mbi këto baza. Në fakt, z. Rees gabon kur tha dje
5 se Trupi Gjykses doli me një konstatim të pabazuar sa i takon
6 alternativës së tretë. Ky argument varet nga interpretimi i
7 tyre i rremë, i pavërtetë.

8 Nëse shohim paragrafin 605 të aktgjykimit, është e qartë
9 që konstatimi mbi shpalljen e fajësisë është bazuar mbi
10 alternativën e parë. Pra, këto konstatime faktike nuk shfaqen
11 në aktgjykim për arsyen krejt të arsyeshme se nuk është e
12 nevojshme që të dilnin në këto përfundime në mënyrë që të
13 dënonin të akuzuarit.

14 Sa i takon pasojave. Nuk ka gjuhë statutore që thotë që
15 duhet të materializohet kanosja. Edhe dispozita është më e
16 thjeshtë në këtë drejtim sa i takon, nëse e krahasojmë me
17 dispozitat e TPNJ-së dhe ICC-së që Mbrojtja s'e pranon. Sa i
18 takon kriterit të pasojës në nenin 387, përsëri kodi prek
19 interesat e mbrojtura.

20 Pse nuk duhet të frikësojmë një dëshmitar i cili dëshiron
21 të thotë të vërtetën ndërkohë që kërcënohet por nuk është
22 viktimë e veprës penale të frikësimit gjatë procedurave
23 penale? Është më e natyrshme dhe më logjike të thuhet që
24 sidogoftë mbetet një krim edhe interpretimi që bën Mbrojtja
25 është e kundërta.

1 Tani kanosja me forcë është po ashtu, po lexoj, një gjuhë
2 që nuk ekziston në dispozitë. Dhe argumentet e Gucatit janë
3 shumë të paqarta nëse shohim transkriptin e drejtpërdrejtë në
4 faqen 45 dhe 47. Kur u përgjigj pyetjes së gjykatësit Ambos,
5 të paktën si e kuptova unë, z. Rees thotë që, ndonëse
6 dispozita në vetvete mbulon detyrimin që është kanosje serioze
7 pa forcë, por nuk është pjesë e këtyre procedurave, sepse
8 Prokuroria e ka ngarkuar në mënyrë të atillë kanosjen me forcë
9 në mënyrë që ta vërtetoni patjetër.

10 Për të kundërshtuar këtë argument. ZPS-ja ka pretenduar
11 sjellje që është objekt i asaj dispozite, por të akuzuarit,
12 sidoqoftë, duhet të shfajësohen sepse fjalët shtesë nuk janë
13 të shkruara në aktakuzë që nuk është kështu. Argumenti nuk
14 thelb. ZPS-ja ka ngritur akuza për një çështje bazuar në një
15 dispozitë që ishe brenda objektit të saj. Dhe Trupi Gjykues e
16 shpalli fajësinë bazuar mbi të njëjta argumente.

17 Sa i takon numrit të dëshmitarëve dhe lidhur me
18 fshehtësinë e procedurave. Asnjë nga këto, as aktakuza, as
19 neni 387, nuk parashikojnë ndonjë prag të veçantë sasior.
20 Duhet të shpjegojnë pse provat që kanë mbetur nuk e mbështesin
21 aktgjykimin edhe dënimin dhe, në fakt, po përpiqet ta bëjë
22 vetëm Mbrojtja.

23 Dua të tregoj një rast konkret që u diskutua dhe është
24 cituar në nenin 567 të aktgjykimit. Që është një nga provat e
25 tjera materiale që vërteton kanosjen serioze. Dhe flet z.

1 Haradinaj në konferencën e parë për shtyp.

2 Nëse mund ta shohim në ekran.

3 [Luhet videoincizimi]

4 Z. HALLING: [Përkthim] "Askush nuk është i panjohur".

5 Këtë thonë kur marrin paketën e parë. Ka shumë prova që e
6 mbështesin konstatimin e Trupit Gjykses dhe nuk përcaktohet
7 asnjë gabim.

8 Sikurse ju thashë, kjo lidhet me fshehtësinë e
9 procedurave sepse Mbrojtja shtrembëron edhe njëherë,
10 konstatimet e Trupit Gjykses. Në faqen 39 të transkriptit, z.
11 Rees tha:

12 "Për qëllim të Pikës 5 vetëm një dëshmitar u konstatua se
13 vërtetë kishte vuajtur nga frika dhe kishte pësuar shqetësime
14 të konsiderueshme".

15 Nuk është e vërtetë. Nuk evidentohet në konstatimet e
16 Trupit Gjykses kjo gjë. Unë besoj që ai e ka fjalën për
17 paragrafin 547 të aktgjykimit, që është në fakt Pika 6, jo
18 Pika 5 dhe është për ata dëshmitarë për të cilët, në fakt,
19 doli me konstatim se kishin pasur pasoja serioze. Pra, nuk
20 kemi një dëshmitar. Janë dy dëshmitarë që janë rialokuar, janë
21 dislokuar. Janë dëshmitarët që kanë qenë objekt i një
22 planifikimi emergjent rreziku. Pra, këta janë dëshmitarët në
23 rrezik.

24 Po ashtu, personi i redaktuar, që është në Arsyen 11, që
25 përmendët në Pikën 11 të Gucatit, ZPS-ja asnjëherë nuk

1 konfirmoi nëse ky apo një person tjetër vërtetë që i përfshirë
2 në hetimet e ZPS-së. Gjithashtu dëshiroj të vë në dukje, se ky
3 dëshmitar është shqiptar, nuk është serb. Pra, nocioni i
4 interesit publik që del në dosjet e apelit, që duhet ekspozuar
5 bashkëpunimi i ZPS-së me Serbinë, nuk mbështetë këtë provë,
6 pra, nuk e mbështet këtë argument. Trupi Gjykses mund të
7 kishte shtuar më shumë elemente pasojave serioze dhe vendosi
8 të mos e bënte.

9 Nuk është pjesë e aktgjykimit. Dhe nëse shikojmë
10 konkretisht dosjen tonë në paragrafin 205, aty ka prova të
11 mëtejshme që mund të ishin përdorur nga Trupi Gjykses. Por,
12 Trupi Gjykses vendosi të mos e bënte për hir të Mbrojtjes. Ata
13 i kufizuan konstatimet e tyre vetëm në provat që ata gjykuan
14 se mund të kundërshtoheshin mjaftueshëm. Dhe ky konstatim
15 duhet të ketë një dallim në apel dhe nuk konstatohet kurrfarë
16 gabimi.

17 U diskutua dhe për burimet ligjore në Kosovë që nuk janë
18 të inkorporuara në ligjet e DSK-së. Edhe, në fakt, ky është
19 një kriter i shprehur në nenin 3(4) të Ligjit tonë, ku
20 përfshihet ligji për klasifikimin, që as i bëhet referencë, as
21 nuk është përfshirë, as nuk është përmendur në ligjet e DSK-
22 së dhe në asnjë akt tjetër në Kodin Penal të Kosovës lidhur me
23 Pikën 5 dhe Pikën 6.

24 Pra, fjala "fshehtësi" që duhet përkufizuar në të njëjtën
25 mënyrë, do të ishte një interpretim i gabuar. Pra,

1 interpretimi i duhur të përdoret fjala "fshehtësi" në term të
2 përgjithshëm, në kuadër të përgjithshëm, që këtë ka bërë dhe
3 në fakt Trupi Gjykes në paragrafin 78 të aktgjykimit.

4 Dhe, po ashtu, doli përsëri dje. Aktakuza është shumë e
5 qartë kur thotë se alternativat lidhur me Pikën 5 nuk janë
6 zbuluar në përputhje me ligjin apo nuk janë deklaruar sekrete
7 me vendim Gjykate, të dyja janë të gabuara. Ju mund ta shihni
8 në paragrafin 33 të aktakuzës dhe pse është lejuar Trupi
9 Gjykes të dalë me konstatime për të dyja alternativat.

10 Ka pasur dhe argumente të tjera që janë përmendur në
11 dosje që nuk dolën dje sa i takon pikës që lidhet me
12 fshehtësinë e procedurave, pra, kryesit nuk duhet të ishin
13 palë e procedurave ku u zbulua informacioni i mbrojtur. ZPS-ja
14 është autoriteti kompetent për klasifikimin e informacionit.
15 Nuk ka asnjë provë që ka pasur shpërdorim të kësaj detyre.

16 Dhe, në fakt, si dëshmitarët e Prokurorisë dhe të
17 Mbrojtjes pranuan se është standarde që të shënohen
18 aktivitetet hetimore si konfidenciale. Edhe provat që pati
19 Trupi Gjykes, që janë të cituara në aktgjykim, tregojnë që,
20 në fakt, i akuzuari e dinte këtë.

21 Do ju tregoj një video tjetër. Kjo është një intervistë
22 që ka bërë z. Haradinaj, që është P8, faqja 26, citohet
23 paragrafi 503 i aktgjykimit.

24 [Luhet videoincizimi]

25 Z. HALLING: [Përkthim] Pra, a mund të kishte dalë një

1 trup gjykues i arsyeshëm që këta nuk kishin dijeni që kishte
2 persona të mbrojtur në materialet që kishin përpara? Kjo
3 lidhet dhe me një refren që përsëritet gjithmonë nga të
4 akuzuarit, është diskutuar në paragrafin 590 që aktgjykimit që
5 ka deklarata të përsëritura që të akuzuarit t'u thonë të
6 tjerëve të mos i bëjnë emrat publik. Dhe e kemi një shembull
7 të dëshmisë së Gucatit lidhur me këtë, që citohet në
8 aktgjykimin në paragrafin 374.

9 [Luhet videoincizimi]

10 Z. HALLING: [Përkthim] Për arsyet në aktgjykim, Trupi
11 Gjykues i kupton të akuzuarit që kur i japin informacion
12 medias pa asnjë lloj redaktimi kur thonë që nuk po i bëjnë
13 emrat publik, kjo është e pabazë, është e pabazë me prova. Ky
14 konstatim duhet të bëjë dallim dhe nuk ka asnjë, as në dosjen
15 e apelit dhe as nuk e përmendën dje, që të justifikonin të
16 kundërtën e kësaj që ka ndodhur.

17 Sa i takon pengimit, dënimit për pengim drejtësie. Dhe u
18 diskutua dje. Është krejt e natyrshme të interpretohet neni
19 401 i Kodit Penal të Kosovës në mënyrë për të përfshirë dhe
20 tentativën për të penguar një person zyrtar përmes sjelljes që
21 ka objekt persona të tjerë apo sende të tjera. Pra, dashja për
22 të penguar një person zyrtar duhet të jetë e qartë në rrethana
23 të tilla.

24 Në fund të seancës dje, z. Rees tha cili duhet të jetë,
25 pra, ligji -- opinionimi i saktë është ai që ka thënë Gjykatësi

1 Barthe në një mendim ndryshe lidhur me Pikën 3 dhe Pikën 1,
2 për të krijuar një element mendor që në fakt nuk ekziston.
3 Pra, personi që nuk pajtohet është Gjykatësi Barthe. Opinioni
4 i tij është i kufizuar vetëm me dashjen direkte lidhur me
5 konstatimin e Pikës 3. Ai nuk e ka të njëjtën logjikë për
6 Pikën 1, që do të thotë vendimi në aktgjykimin që ai
7 nënshkroi, pra, që vlente dashja kur u interpretua kjo
8 dispozitë, ende e njëjta gjë vlen.

9 Ju e lexuat dje aktgjykimin e Salihu dhe të tjerë. Edhe
10 nuk u lexua i plotë në fakt. Dhe unë ju inkurajojë, të nderuar
11 Gjykatës, ta lexoni edhe njëherë në fillim paragrafin në faqen
12 1165, sepse autori i Salihut jep dhe kontekstin se çfarë
13 nënkuptojmë kur flasim për drejtimin e pengesës që nuk është
14 në përputhje me atë që thanë ata. Ata flasim për dhunën në
15 1165, dhunën kundrejt objekteve dhe japin një shembull.

16 "... një dëm është, dëmtimi i një instrumenti matës në
17 mënyrë që mos të matet toka".

18 Kjo ishte dhe pikërisht pjesa që po ju lexonte ju
19 Mbrojtja e Haradinajt dje. Janë veprime që kanë për subjekt
20 një objekt, që synojnë të dëmtojnë një objekt dhe tregojnë
21 dashjen specifike dhe mënyrën sesi lexuan ata që, në fakt, nuk
22 është në përputhje me atë që është cituar aty në të vërtetë.

23 Është e qartë se Mbrojtja duket sikur ka dijeni që e kanë
24 tejkaluar elementin e ndarë kur flasim për shkëmbimin në
25 transkriptin dje, në transkriptin e djeshëm, faqja 77, kur z.

1 Ambos po jepte shembullin e pengimit të një dëshmitari privat
2 ose tentativa për të penguar një person zyrtar. Është
3 interesante. Ai tha, po, mund të jetë e mundur, por provat nuk
4 e mbështesin këtë gjë, s'ka prova për këtë gjë.

5 Më vjen keq të them për z. Cadman, por Arsyeya 18 në
6 dosjen e Haradinajt, ku pretendohet ky gabim, është pretenduar
7 si gabim juridik. Në momentin që Mbrojtja e Haradinajt e
8 pranon që është e mundshme sipas dispozitës, atëherë duhet
9 vendosur një X kësaj arsyeje. Nuk është gabim juridik më. Dhe,
10 sigurisht, që nuk është gabim juridik. Interpretimi i Trupit
11 Gjykues është i arsyeshëm, ka kuptim po ashtu.

12 Kemi një dispozitë tjetër ku ka pasur ndryshime të
13 njëmendta legjislativë dhe diskutohet në paragrafin 144 të
14 aktgjyimit. Kodi i Përkohshëm në Kosovë dhe dispozita, neni
15 ekuivalent, kishin frazën "me forcë ose duke e kanosur për
16 përdorim të menjëhershëm forcën" që tani është "forcë për
17 kanosje serioze". Pra, ka qenë e parashikuar kanosja me forcë
18 në dispozitë që tani është zhvendosur dhe kjo duhet të
19 kuptohet kur interpretohet autoriteti që disponon dispozitat.

20 Është marrë parasysh çështja *M.I. edhe të tjerët* në
21 dosjen e apelit. Aty diskutohen dispozitat, dispozitë për
22 dispozitë të kodit, që do të thotë ka gjuhë tjetër statutores
23 dhe elementë të ndryshëm dhe kjo duhet marrë parasysh kur të
24 përdoret ky aktgjykim si bazë në çdo kontekst.

25 Ky aktgjykim po ashtu del edhe në Pikën 2, që nuk u

1 diskutua në tërësi dhe edhe do doja ta trajtoja pak
2 shkurtimisht. Faton Klinaku vetë synonte të pengonte zyrtarë
3 të ZPS-së për arsyet e paraqitura në aktgjykim. Qoftë me
4 dashje direkte apo eventuale, kjo mjafton për të marrë pjesë
5 në një grup që tenton të pengojë me veprime të përbashkëta.
6 Dhe mund ta shihni nga arsyetimi që është në paragrafin 700 të
7 aktgjykimit që z. Klinaku e ka pasur dashjen eventuale në
8 fakt.

9 Gjithashtu del edhe kjo në rastin e dënimeve kumulative,
10 që është përmendur në Arsyen 14 të apelit të Guçatit, që doja
11 ta trajtoja shkurtimisht.

12 Testi i dënimeve kumulative që ka përdorur Trupi Gjykses
13 është i përshtatshëm, është brenda, është në përputhje me
14 ligjin e Kosovës dhe është një standard i mirë, është një test
15 i mirë. Për dikë që bie dakord, unë dhe mund të citoj diçka.
16 Kur e pyesin për këtë test, për këtë element kaq reciprok apo
17 të materialitetit "asnjë parim i specialitetit reciprok,
18 shkelje më të vogla, nuk do të thotë që Gjykata duhet të jetë
19 në sensin e përgjithshëm, por, sepse e kanë shpjeguar shumë,
20 shumë qartë cilat janë parimet e përgjithshme, cilat janë
21 elementet e probabilitetit dhe të dënimit".

22 Ky citim është i Jonathan Rees. Në deklaratat përmbyllëse
23 ka thënë diçka të tillë. Faqja 3823 dhe faqja 3824 e
24 transkriptit. Dhe, në fakt, duhen përdorur sepse testohet
25 koha. Ka një gamë jurisprudencash të TPNJ-së që interpretojnë

1 këtë lloj testi që parashikon dhe të jep mundësinë që të
2 zbatohet në mënyrë më të besueshme nëse përdoret në DHSK.

3 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Z. Halling, a mund t'ju
4 ndërpres një moment, se kam disa pyetje për ju.

5 Para se të flasim për këtë testin dhe marrëdhënien mes
6 paragrafit 1, 2 dhe 4, unë dua të flas pak për nenin 387. Nuk
7 e di a do ta diskutoni ju këtë nen. Por unë doja t'ju bëja
8 sidoqoftë një pyetje. Si e interpretoni ju elementin të
9 nxisësh në këtë nen? Të nxisësh si e interpretoni ju këtë
10 fjalë?

11 Z. HALLING: [Përkthim] Në të njëjtën mënyrë si është dhe
12 në aktgjykim. Nuk është deklaratë e dashjes specifike. Ne e
13 argumentuam në gjykim që është krejt ndryshe nga mënyra sesi
14 është interpretuar në nenin 388. Pra, në përgjithësi dhe
15 aktualisht, Trupi Gjykses nuk konstatoi dashje specifike atje.

16 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Meqë ju iu referuat mendimit
17 të ndryshëm të gjykatësit Barthe, besoj se ju e njihni që ne
18 kemi një parim që njihet si parimi i ligjshmërisë, që është
19 një parim dhe në të drejtën kosovare dhe është mishëruar në
20 nenin 2(3) të Kodit Penal të Kosovës. Sipas këtij parimi,
21 dikush duhet të interpretojë dispozitat në kuptimin e ngushtë,
22 shumë të saktë dhe termat që mund të tregojnë një përkufizim
23 më të ngushtë duhen interpretuar në atë formë në fakt. Dhe ky
24 ka qenë dhe argumenti i gjykatësit Barthe në atë pjesë të
25 mendimit mospajtues që pati ai.

1 Pra, nëse unë ju kuptoj siç duhet, ju nuk i merrni fare
2 parasysh, nuk i kushtoni rëndësi foljes, kallëzuesit "për të
3 nxitur", pra, ti thua që dhe mund ta heqim fare këtë folje nga
4 dispozita dhe s'do kishte asnjëfarë ndryshimi.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk besoj se do shkoja kaq larg.
6 Por mënyra sesi është formuluar kjo dispozitë, nuk të lë të
7 kuptosh sesa elementi automatik mendor i dashjes, që do të
8 zbatohej për këtë dispozitë, që e diskutuam në dosjen tonë
9 edhe nëse është pranuar mendimi i Gjykatësit Barthe, është një
10 mendim ndryshe edhe ai, në fakt, pranon se ka dashje direkte
11 në Pikën 3.

12 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Ky është një element. Kjo
13 është një pikë tjetër. Po, mund të themi nëse e pranojmë
14 dashjen direkte, ju thoni ju është vërtetuar dashja direkte.
15 Ky është një debat akademik.

16 E kuptoj çfarë doni të thoni, por kur thoni "element
17 automatikisht" ç'e keni fjalën kur thoni "element
18 automatikisht"?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Unë po i bëj referencë në fakt,
20 nenit që lidhet me dashjen direkte.

21 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Pra, ju nënkuptoni --

22 Z. HALLING: [Përkthim] Po është dashje direkte.

23 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Po. Atëherë shohim nenin 401.
24 Për t'ju kthyer diskutimit dje. Nuk e di çfarë ëndrrash pa z.
25 Rees në fakt. Po nëse shkojmë dhe një herë tek formulimi i

1 nenit 401. Besoj që të gjithë duhet ta marrin fjalë për fjalë
2 këtë dispozitë.

3 Dhe, sa i takon ligjshmërisë, që është pjesë e të drejtës
4 kosovare. Nëse thotë "tenton të pengojë personin zyrtar",
5 tenton të pengojë personin zyrtar, tani unë po vras mendjen, a
6 nuk nënkupton kjo që edhe në çështjen e tentativës personi që
7 tenton duhet të ketë shënjestër një person zyrtar?

8 Z. HALLING: [Përkthim] Fjala kyçe është "shënjestër" në
9 fjalën tuaj. Ne nuk jemi dakord me Mbrojtjen kur thonë që ka
10 një element specifik në këtë dispozitë sepse gjuha statutore
11 nuk e shpreh. Por duhet të pranojmë që sa herë pengon apo
12 tenton të pengosh një person zyrtar, duhet të kesh sigurisht
13 përpjekjen, pra, duhet të ekzistojë dhe përpjekja për ta
14 penguar këtë person edhe në qoftë se veprimet kanë për synim
15 një person të tretë apo një objekt.

16 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Tani më ngatërrove më shumë.
17 Pra, ju bini dakord që përmbushja e *actus reus* apo konsumi i
18 veprës penale kërkon që ju të pengoni një person zyrtar, siç
19 thuhet në dispozitë. Ju nuk thoni që mjafton të pengosh një
20 person privat sipas kësaj dispozite.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Po. Dhe ky është edhe konstatimi i
22 Trupit Gjykues.

23 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Prandaj, në fakt, Trupi
24 Gjykues përmend tentativën. Atëherë çfarë është përpjekja,
25 çfarë është tentativa sipas jush? Nëse ju na thoni mbeti në

1 tentativë, pra, pengesë e mbetur në tentativë edhe pse nuk ju
2 drejtua një personi zyrtar?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Ky ishte misioni i të akuzuarve,
4 të shkatërronin këtë institucion dhe ata zbulojnë informacion
5 të mbrojtur në mënyrë që të shkatërrojnë veprimtarinë tonë dhe
6 operacionet tona. Dhe po të shohësh provat që ka pasur në
7 gjykimin e Trupit Gjykses, ata duan të dëmtojnë Gjykatën, duan
8 të shkatërrojnë atë në pesë minuta thonë. Është në këto
9 paragrafë. Ky ishte synimi i tyre.

10 Pra edhe në qoftë se veprimet e tyre synonin persona
11 privatë, ne kemi përfshirë personin zyrtar aty dhe kjo
12 mbështetet nga konstatimet e Trupit Gjykses.

13 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Atëherë flasim pak për
14 marrëdhënie mes paragrafit 1 dhe 2, sa i takon kësaj *concour*
15 apo që ju e quani dënimet kumulative. Ju merrni një
16 jurisprudencë Blockburger që ka qenë e TPNJ-së edhe e keni
17 zbatuar në këtë rast. Por duhet të biem dakord që ne këtu
18 duhet të kemi parasysh ligjin tonë dhe të drejtën e Kosovës,
19 Kodin Penal të Kosovës. Dhe mua më duket se Kodi Penal i
20 Kosovës është shumë i qartë, e drejta kosovare zbatohet
21 *concour d'infraction*, pra, *concour d'infractions* që është në
22 frëngjisht, pra, zbatohet dhe në këtë rast.

23 Pra, nëse jeni dakord që duhet të zbatojmë jo në vetvete
24 të drejtën ndërkombëtare por të drejtën e Kosovës, konkretisht
25 të drejtën penale, ju jeni dakord që duhet të zbatojmë këtë?

1 Z. HALLING: [Përkthim] Jam dakord, po në këtë rast ka një
2 farë ndryshimi dhe janë në përputhje me njëra-tjetrën në fakt
3 dhe unë mund t'jua ilustroj këtë.

4 Kemi një rast në Kosovë që është aktgjykimi *K.P., PAKR-*
5 *1122* i vitit 2012 është çështja.

6 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Unë do isha i interesuar ta
7 lexoja këtë çështje. Pra, autoriteti kosovar në thelb citon
8 testin Blockburger dhe thotë që testi Blockburger është njësoj
9 si *concour*, parimi *concour*.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Ka mjaft kopje këtu për të gjithë
11 këtu që mund të lexoni, kam për ekipin e Mbrojtjes, kam edhe
12 për Trupin Gjykses. Edhe paragrafi që duhet të lexoni, që
13 është më i rëndësishmi, është paragrafi 28.

14 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Pra, argumenti është që e
15 drejta e Kosovës e pranon më së paku testin Blockburger? Ne do
16 ta verifikojmë këtë në fakt, këtë autoritet. Kjo është një nga
17 gjërat. Po a mendoni ju që është e mundur që të zbatohet testi
18 *concour*, që është një test që ne e bëjmë në të drejtën
19 gjermane, franceze dhe vjen nga e drejta evropiane
20 kontinentale? Trupi Gjykses tha që nuk e kuptonin në
21 aktgjykim, nuk e kishin kuptuar pse ishte bërë kjo referencë e
22 Gjykatës Supreme të Kosovës ku u zbatua ky *concour*. Kjo nuk
23 do të thotë që ne nuk do ta zbatojmë diçka. Ne, thjesht si
24 gjykatës, do të përpiqemi të kuptojmë diçka para se ta
25 zbatojmë diçka.

1 A e pranoni që është pyetje e hapur kjo se çfarë
2 standardi zbatohet ne dhe në qoftë se na jepni këtë material,
3 që unë do ta lexoj më vonë, nëse kemi një traditë të qartë të
4 paktën, traditë evropiane për standardin *concour*s që zbatohet.
5 Dhe një herë, ne këtu kemi Kosovën dhe duhet të përpiqemi të
6 zbatohet të drejtën e Kosovës.

7 Z. HALLING: [Përkthim] E vlerësoj këtë, prandaj dhe u
8 përpoqëm të gjejmë autoritetin kosovar për këtë. Do të binim
9 dakord, në fakt, që parimet e të drejtës penale ndërkombëtare
10 për dënimet e bashkuara gjenden në ligjin e Kosovës. Dhe,
11 ndoshta, nuk është e nevojshme mbase nuk është i vetmi.

12 Dhe shembull për këtë është gjykatësi Barthe, i cili
13 përdor parime të orientuara më shumë nga tradita e të drejtës
14 civile dhe vjen në të njëjtin përfundim në këtë rast. Mendojmë
15 se ka rëndësi të përdoret ky test. Ka edhe raste të tjera ku
16 do të dali kjo çështje.

17 Por, për qëllimet e interpretimit të Kodit Penal të
18 Kosovës, ka mënyra të shumta për ta interpretuar. Jam dakord.
19 Por nuk është patjetër interpretimi i drejtë. Dhe gjykatësi
20 Barthe do të thoshte po të ndiqni këtë rrugë, qëndron shpallja
21 fajtor.

22 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Kjo më sjell te një pyetje
23 tjetër, ju i dolët përpara dhe kjo është një pyetje me rëndësi
24 praktike. Dhe është si e interpretoj marrëdhënien midis 1 dhe
25 2? Çështja kyçe këtu është, një person mund të shpallet fajtor

1 për dy akuza? Akuza jo në kuptimin e dispozitës. Njëra është
2 kërcënimi individual, paragrafi 1 dhe tjetra është një vepër e
3 kryer nga një grup, nga një kolektiv.

4 Cili është dallimi midis dy dispozitave që justifikojnë
5 dhe qëndrimin, mbështetur nga Trupi Gjykues dhe nga ju, që
6 personi shpallet fajtor për të njëjtën sjellje për të dy
7 dispozitat, bazuar në të dy dispozitat?

8 Z. HALLING: [Përkthim] Përgjigja është e drejtpërdrejtë:
9 Ka një element në Pikën 1 që nuk është në pikën 2 dhe e
10 kundërta dhe kështu mund të shpallësh fajësi për të dyja. Po
11 të ndjekësh logjikën e gjykatësit Barthe, është ajo e
12 bashkimit ideal sepse bëhet fjalë për elementin e grupit në
13 Pikën 2 dhe është një interes tjetër i mbrojtur krahasuar në
14 atë në njëshin.

15 Një autoritet me rëndësi mund të ishte aktgjykimi në
16 *Bemba e të tjerë*. Po të shikosh paragrafin 751 të këtij
17 aktgjykimi, shikon që Gjykata e Apelit në GJPN u përball me të
18 njëjtën çështje si tani këtu. Është një çështje përbuzje
19 gjykate, ku dolën me konkluzione të testit të Blockburger dhe
20 kishte një person, një nga gjykatësit që kishte mendim të
21 veçantë që mbështetej më shumë në traditat e të drejtës
22 civile.

23 Por Paneli i Apelit tha se është e argumentueshme që
24 "shpallje fajësie të tilla mund të jepen, mund të shpallen për
25 vepra që kanë elementë të ndryshme që shikohet si të varur nga

1 një vepër më përpara".

2 Me fjalë të tjera, mund të bëhej me mënyra të ndryshme
3 por, nuk e ktheu vendimin e Trupit Gjykues, as interpretimin
4 ligjor të Trupit Gjykues sepse parimet e varësisë dhe të
5 konsumimit kishin të njëjtin rezultat. Pra, mund të thuhet
6 thjesht që autoriteti, ai kishte gabim dhe me kaq ta lësh.

7 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Faleminderit shumë. Ishte i
8 qartë shpjegimi juaj. Desha vetëm të sqaroja se bashkimi
9 ideal, po, i korrespondonte si i Blockburger por jo konsumimi
10 i varësisë. Këto janë forma të cilat francezët do t'i quanin
11 bashkime të rreme.

12 Unë e kuptoj këtë që thoni ju, por çështja shtrohet një
13 element i dallueshëm në të dy paragrafët e të njëjtit
14 dispozitë, dispozitë justifikon dënimin e dyfishtë në qoftë
15 se, për pjesën e mbetur, dispozita e dytë mund të jetë e
16 varur. Pra, kjo është çështja kyçe që ne duhet të vendosim
17 përveç diskutimit akademik lidhur me testin që përdorin.

18 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Mund të flas?

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Z. Cadman.
20 Dëshët të flisnit, z. Cadman?

21 Z. CADMAN: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Shumë shkurt.
22 Me që jam larg, unë jam në distancë e nuk çohem dot në këmbë.
23 Nuk kam një kopje të shtypur të aktgjykimit dhe ju lutem ma
24 dërgoni të paktën në formë elektronike që shqyrtoj gjatë
25 pushimit.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Do t'jua dërgojmë.

2 Në qoftë se nuk ka pyetje të tjera lidhur me shpalljen
3 fajtor për bashkimin e veprave, do t'i kthehem diskutimit
4 lidhur shtytje për kryerjen e veprës penale që u ngrit më
5 herët nga z. Whiting dhe nga ju.

6 Bazuar në prova, çdo çështje e shtyrjes për vepër penale
7 nuk ekziston. Nuk ka prova. Dhe është konstatuar nga Trupi
8 Gjykues në atë që do ta quaja me hollësi të mëdha dhe asgjë
9 nuk e mbështet atë.

10 Sa për të vënë në dukje shkallën në të cilën Trupi
11 Gjykues ka shqyrtuar çdo gjë, sesioni i fundit lidhet me
12 tregues rrethanor të Mbrojtjes së Gucatit. Asnjë, jo të gjitha
13 janë paraqitur në dosjen e fundit të Gucatit dhe arsyeja është
14 sepse ndryshuan mendjen apo hoqën dorë prej disa prej këtyre
15 nga dosje paraprake në dosjen përfundimtare. U kthyen përsëri
16 në fillimin e çështjes për t'u siguruar gjykatësit, për të
17 adresuar çdo çështje që kishte ngritur Mbrojtja në çdo moment
18 edhe pse s'e kishin në dosjen përfundimtare që shprehte
19 qëndrimin e tyre.

20 Lidhur me pragun. Ka një prag. Është një prag minimal,
21 siç e përshkroi z. Whiting. Por mënyra si e shpreh Mbrojtja
22 është sikur të mos ketë fare asnjë lloj pragu, asnjë lloj
23 standardi. Dhe për një moment dua të mbështetem tek çështja
24 Ramanauskas 2, që ishte autoriteti që ata përshkruan dje.
25 Është përshkrimi i formulës absolutiste. I testit të

1 pamundësisë së plotë.

2 Është mendimi i Gjykatësit dhe i GJEDNJ-së në
3 përgjithësi. Dhe për të qenë i drejtë me z. Rees, ai e
4 përmendi se gjykatësi Kuris e përmend si një formulë
5 absolutiste, sikur po qajej.

6 Por, në fakt, ka dhe më shumë nuanca se atë. Është një
7 rast tjetër që do t'ju inkurajoja të lexonit pjesën pas këtij
8 citimi. Po të shikoni paragrafin 12 të opinionit, Gjykatësi
9 flet sesi GJEDNJ-ja ka përdorur termin në mënyrë, fjalë për
10 fjalë si të thuash, në mënyrë absolutiste por këtë e thotë jo
11 shpesh, pra, nuk është një qëllim uniform.

12 Ajo që është më interesante, gjykatësi Kuris thotë që
13 mund të përdoren parime të interpretimit ligjor për t'i dhënë
14 termit "jo plotësisht i pamundur" t'i japë një kuptim më
15 literal. Pra, nuk është vetëm se gjykatësi Kuris ankohet për
16 këtë formulën absolutiste, por pranon se nënkuptohet jo në
17 mënyrë të vazhdueshme dhe thotë që janë parimet ligjore që të
18 ndihmojnë që ta interpretosh më mirë.

19 Ky është autoriteti ku mbështetet Mbrojtja e Gucatit për
20 pikat ligjore që ngritën. Morën kohë para jush më shumë sesa
21 kishin për të mbrojtur argumentet e tyre.

22 Ka dhe mbrojtje të tjera të cilat diskutohen në dosje, të
23 cilët nuk u referuan shumë dje. U përmend shkurtimisht
24 sinjalizuesi apo sinjalizimi. Por, në ligj kjo është shumë e
25 qartë. Nuk bëhet fjalë për marrëdhënie punësimi në këtë rast.

1 Nuk ka prova që i akuzuari ka qenë në marrëdhënie të tilla.
2 Ndërhyrja me të drejtën e lirisë së shprehjes pasqyrohet shumë
3 mirë në aktgjykim dhe është në përputhje me ligjin dhe
4 proporcional.

5 Interesi publik u shqyrtua plotësisht përfshirë të gjitha
6 argumentet e lidhur me Serbinë. Kuadri ligjor i Gjykatës i jep
7 ZPS-së të drejtë ligjore për të bashkëpunuar me Serbinë dhe
8 mund të shikoni paragrafin 813, gjë që dihej në kohën që u
9 dhanë paketat. Të akuzuarit nuk po nxirrnin këtë në dukje kur
10 publikuan këto dokumentet. Ata e dinin që ishin të dhëna
11 konfidenciale dhe dëshmitarë të mbrojtur.

12 Dhe nuk ka asnjë provë për papërshtatshmëri dhe Trupi
13 Gjykues i shqyrtoi provat në paragrafin 814 të aktgjykimit.

14 Nuk e di nëse ka shumë gjëra për të thënë lidhur me
15 veprimet pak të rëndësishme. Ky është një shembull tjetër i
16 përmendjes shkurtimisht nga ekipi Mbrojtës dhe në dosjen e
17 tyre të gjykimit dhe pastaj heqin dorë prej saj, pastaj i
18 kthehen prapë, kthehen prapë në fillim për t'u siguruar që të
19 dëgjohet çdo gjë, arsyetohet dhe gjykohet mirë si Trup Gjykues
20 kur dalin me konstatimet e tyre.

21 Shpalljet fajtorë të gjetura nga Trupi Gjykues janë
22 gjetur me shumë punë të kujdesshme. Kundërshtime të këtyre
23 vendimeve do të përfundojnë në mënyrë të ditur. Gjatë gjithë
24 këtij Apeli, Mbrojtja ka mbajtur qëndrim të kundërt me Trupin
25 Gjykues, ka qenë jo e organizuar dhe keqorientuese. Sot në

1 mëngjes u tha që të gjithë e thanë atë që dëgjuam, që
2 gjithkush mund t'i shikonte ato që kanë ndodhur. Rruga, përmes
3 të cilës u arritën këto përcaktime dhe dënimi i shpallur, ka
4 qenë e drejtë dhe e arsyeshme në çdo hap.

5 Dhe z. Pace do të flasë më shumë për këto pika.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

7 Faleminderit.

8 Z. PACE: [Përkthim] Mirëmëngjes. Dhe faleminderit që
9 pritët derisa unë të organizohem.

10 Po filloj duke folur në rastin e Guca Tit Pikën 2(A) dhe
11 për Haradinaj pikën pjesë të saj.

12 Dje dëgjuam shumë referenca ndaj konceptit të drejtësisë,
13 barazisë. Por, në bazë të parashtrimeve në apel nuk kishte
14 precizon, thelb dhe fund, asnjë të vërtetë në këto akuza të
15 përgjithshme.

16 Parashtrimet e djeshme në veçanti e shpërfillën punën e
17 Trupit Gjykes dhe të Gjykatësit të Procedurës Paraprake. Roli
18 i tyre është marrë me shumë seriozitet, duke u lejuar palëve
19 të bënin parashtrime të gjera dhe duke zgjidhur çështjen në
20 mënyrë të drejtë dhe të arsyetuar, vendime të cilat ishin
21 transparente dhe të hapura për publikun dhe për palët për t'u
22 apeluar.

23 Ato siguruan që të drejtat e të akuzuarit të mbroheshin
24 plotësisht. Qasja e ndjekur ishte e tillë që mund të ndiqej
25 nga të gjithë. Dhe qasja e tyre duhet respektuar.

1 Në parashtrimet e Mbrojtjes për nxjerrjen kishte shumë
2 ujë, por qëndrimi i Trupit Gjykses është i qartë. ZPS-ja nuk u
3 përpoq të paraqiste si prova, prova nga këto paketa, nuk
4 lejohej. Dhe meqë nuk u pranua si provë, Trupi Gjykses nuk
5 mundej dhe nuk i përdori në aktgjykim.

6 Nuk është një përkufizim i ngushtë i provave siç
7 pretendon Mbrojtja e Haradinajt. Është realitet. Dhe realiteti
8 është që Mbrojtjes nuk ju hoq e drejta për të pasur qasje në
9 prova.

10 Ajo që ka rëndësi është se Trupi Gjykses kishte shumë
11 prova për t'u mbështetur dhe për të nxjerrë vendime të lidhura
12 me përmbajtjen dhe konfidencialitetin e dokumenteve të bëra
13 publike nga apeluesit. Trupi Gjykses përdori, shqyrtoi shumë
14 prova. Midis tyre janë disa faqe nga paketat të cilat u nxorën
15 dhe më pas u pranuan si prova.

16 Mbrojtja i kalon këto fakte të rëndësishme dhe dua t'ju
17 kujtoj disa informata me rëndësi. Gjithë Paketa 2, që është
18 prova P104, u nxor me redaktime minimale në gjashtë faqe, që
19 ZPS-ja pretendon se përmbajnë informacion konfidencial. Dje u
20 bënë parashtrime të pasakta lidhur me këto dokumente.

21 U nxorën edhe gjashtë faqe nga Paketa 4 dhe 11 nga
22 njëshi. Dhe dua që t'i shikojmë shkurtimisht faqet e nxjerra
23 nga Paketa 1, që janë provat 93 dhe 97 dhe janë për t'u
24 transmetuar vetëm në sallën e gjyqit dhe 199 [sipas
25 përkthimit] deri 204 [sipas përkthimit].

1 Po t'i shikoni, do të shikoni logot, emblemat, emrat e
2 TFHS-së, emrat e personave, referencat ndaj UÇK-së dhe ndaj
3 konfidencialitetit. Kërkesa për informacion nga TFHS-ja
4 autoriteteve serbe, përfshirë dhe persona, emra personash që
5 tani janë dhe dy nga ata që janë të akuzuar te *Thaçi dhe të*
6 *tjerë*. Apo vende ku janë zhvilluar intervistat e TFHS-së me
7 dëshmitarët.

8 ZPS-ja nxori gjithashtu dhe u pranua nga Trupi Gjykses 17
9 faqe nga Paketa 3 dhe faqet korresponduese të paketës tjetër.
10 Dhe këtu përfshihet një përmbledhje e shkurtër. Të shkojmë në
11 faqen e parë të kësaj përmbledhjeje të shkurtër.

12 Dhe është për t'u përdorur vetëm në sallën e gjyqit.

13 Është faqja e parë nga P107. Siç e shikoni, vetëm kjo
14 faqe përshkon objektin e gjithë dokumentit. I referohet emrave
15 të pesë personave dhe disa vendeve në poshtëshënimin e parë.

16 Faqet e mëtejshme të përmbledhjes së shkurtër përfshijnë
17 tituj dhe poshtëshënime dhe që tregojnë logon dhe shënimin
18 konfidencial, po e shikoni në faqen 3 që është pjesë e të
19 njëjtës provë materiale. Faqe të tjera identifikojnë me emra
20 viktimat e pretenduara të krimeve të ndryshme, bashkë me
21 referenca lidhur me vendin dhe kohën kur është kryer krimi.
22 Poshtëshënimet i referohen dëshmime, deklaratave dhe provave
23 dokumentare.

24 Siç u tha nga Prokurori i Specializuar në detyrë, nuk
25 janë të vetmet që kanë marrë në shqyrtim Trupi Gjykses. Ata

1 kanë shqyrtuar dhe deklaratat e njëkohshme të bërë nga
2 apeluesit, dëshmitë e tyre gjatë gjykimit, artikuj të medias
3 dhe dëshminë e 4866. Gjithashtu, Trupi Gjykues u mbështet edhe
4 ke Dëshmitari me numër 4841.

5 Pra, gjithashtu u përdorën tabela për t'u siguruar që
6 Mbrojtja të dinte hollësitë e të gjitha dokumenteve në Paketën
7 1 dhe 4 dhe gjashtë faqet e Paketës 2.

8 Znj. Sekretare, diapozitivi tjetër dhe të tjerat vijuese
9 mund të jenë publike.

10 Ne pamë dje këtë provë materiale gjatë parashtrimeve të
11 Mbrojtjes dhe janë nga prova P90. Është një tabelë e përdorur
12 nga dëshmitari, të cilit ju bënë pyetje këtu, nga 4841.

13 Përfshin përshkrime, data dhe origjinën e autoriteteve të
14 cituara dhe emra të dëshmitarëve potencial. Dhe i keni besoj
15 në ekran tani.

16 Dhe njëherë, për procesverbal, është nga P90.

17 Kur ju të shqyrtoni këto prova, është e qartë që Trupi
18 Gjykues është mbështetur në një bazë të fortë, të shëndoshë,
19 mbi të cilën ka nxjerrë përfundimet e veta. Mbrojtja nuk
20 kërkoi të apelonte vendimet e Trupit Gjykues.

21 Në kundërpërgjigjen e vet, Gucati pretendon se është
22 treguar -- ai e pranon se fakti që ZPS-ja u autorizua të mos
23 nxirrte dokumente nuk ishte i padrejtë. Argumenti i tij se
24 Trupi Gjykues e lejoi ZPS-në të paraqiste prova për pjesë jo
25 të nxjerra, siç është fjala e tabelave të ndryshme dhe që u

1 paraqitën Dëshmitarit 4846.

2 Ka rëndësi të kujtohet që, Trupi Gjykues vuri në dukje
3 se, Mbrojtja nuk kundërshtoi dëshminë e Dëshmitarit W1253.
4 Sepse hetimet ishin konfidenciale dhe këtu përfshihej, për
5 shembull, gjithë produkti i brendshëm dhe informacioni që
6 kishte të bënte me dëshmitarët.

7 Së fundi, Paneli i Apelit duhet të ketë parasysh arsyet
8 përse ZPS-ja nuk u autorizua të nxirrte të gjitha paketat. U
9 tha dje që apeluesit nuk u përpoqën të sulmonin, ta atakonin
10 vendime të tilla. Të shohim disa video që mund të shpjegojnë
11 këtë qasje.

12 Siç thashë, të gjitha këto prova që do të paraqesë janë
13 publike.

14 [Luhet videoincizimi]

15 PACE: [Përkthim] Ky është z. Haradinaj në 22 shtator 2020
16 që prapë do të nxirrte dokumente edhe po të dënohej me 300
17 vite. Dhe kjo është nga prova materiale 35.

18 [Luhet videoincizimi]

19 Z.PACE: [Përkthim] Ky ishte z. Gucati në 22 shtator 2020
20 që asnjë milimetër nuk pendohet për publikimin e dokumenteve
21 "edhe nëse do të më dënonin me pesë vjet me burg". Dhe kjo
22 është nga prova P28.

23 Edhe po të kryenin krime të njëjta, siç e shikojmë në
24 dëshminë e tyre që do të dëgjojmë tani.

25 [Luhet videoincizimi]

1 Z.PACE: [Përkthim] Pra, z. Gucati pyetet nëse do ta
2 përsëriste prapë dhe e bën shumë të qartë. Dhe kjo ka ndodhur
3 në 8 dhjetor 2021, kurse ajo që pamë më përpara ishte në datën
4 13 janar 2022.

5 Arsyet pse ZPS-ja u autorizua të mos i nxirrte të gjithë
6 dokumentet janë të pa -- nuk mund të atakohen.

7 Dhe tani kthehem tek Pikat 17 dhe 16 të apelit që kanë të
8 bëjnë me nxjerrjen dhe drejtësinë.

9 Mbrojtja nuk kishte asnjë rast kur nuk është lejuar
10 Mbrojtja të mbrohej. Duket se Haradinaj kundërshton procedurën
11 e rregullit 108. Në qoftë se dokumentet në diskutim, do t'i
12 ishin dhënë Mbrojtjes përpara vendimit përkatës, do të binte
13 ndesh me këtë rregull.

14 Haradinaj këmbëngul se duhet të kishte qenë i pranishëm
15 në seancën *ex parte* kur është diskutuar dhe kjo është
16 ilogjike, nuk është logjike.

17 Tani i kthehem çështjes së dënimit që trajtohet në Pikën
18 20, 24 të dosjeve të tyre të apelit përkatësisht dhe dje.
19 Dënimi i përshtatet rrethanave dhe peshës së krimit të kryer.
20 Fokusi këtu, duhet të jetë tek krimet e të apeluesve, për të
21 cilat Trupi Gjykes gjykoi ato të kryera prej tyre dhe jo nga
22 persona që nuk janë apelues për krime, në kontekstin, që nuk
23 janë ato me të cilat po merremi në këtë rast.

24 Në parashtrimet e tyre të apelit, përfshirë dje, Mbrojtja
25 nuk thotë që Trupi Gjykes duhet të kishte krahasuar një gjë

1 me një gjë, të njëjtat gjëra, por, sepse nuk ka çështje të
2 jetë ekzakt si kjo. Dje, Mbrojtësi i Haradinajt pranoi se dhe
3 po citoj "të gjitha rastet e përmendura ndryshojnë shumë nga
4 ajo e z. Haradinaj" dhe mbaron citimi. Në fakt, çështja që
5 përmend Mbrojtja nuk është e barabarta me këtë, po të përdorë
6 të njëjtën shprehje që u tha dje. Përgjigja jonë prek disa
7 ndryshime në ato çështjet e cituara nga Mbrojtja.

8 Sa për të thënë një ndryshim është çështja Margetiç për
9 shembull. Në paragrafin 88 të aktgjykimit, dhoma e TPNJ-së tha
10 se qëndrimi i të akuzuarit në atë rast nuk mori parasysh
11 sigurinë e dëshmitarëve. Trupi Gjykses i dëgjoi vetë të
12 akuzuarit kur deklaruan, ku deponuan këtu që, dëgjuan edhe një
13 minutë përpara, se do t'i kryenin prapë ato krime.

14 Gucati thotë, se asnjë nga autoritet e cituara në
15 përgjigjen e Mbrojtjes së ZPS-së, nuk shkojnë aq larg sa Trupi
16 Gjykses në dhënien e dënimit krahasuar me gjykatat e tjera. Të
17 marrim parasysh disa nga autoritet e cituara nga ZPS-ja në
18 poshtëshënimet e dosjes së vetë.

19 Në ekran keni një nga citatet e cituara dhe është
20 paragrafi 22 i çështjes së përbuzjes së Gjykatës së Lebanonit.
21 Këtu thuhet:

22 "Së fundi, konstatoj se jurisprudenca e tribunalëve të
23 tjerë ndërkombëtarë të cituar nga palët kanë të bëjnë me
24 çështje të cilat janë shumë të ndryshme në ligj dhe në fakt
25 nga kjo. Si rezultat, në përcaktimin e dënimit të vendosur në

1 këtë rast nuk mund të udhëhiqem nga dënimet e vendosura në ato
2 çështje” përfundon citimi.

3 Në një tjetër jurisprudencë, e cila është referuar në
4 këtë poshtëshënim që jepet në ekranet tuaja, që është çështja
5 Babiç, Gjykata e Apelit e TPNJ-së deklaroi si më poshtë:

6 “Efekti i precedentit i dënimeve të mëparshme të dhëna
7 nga tribunalët ndërkombëtarë dhe TPNJ-ja, nuk është thjesht
8 ‘shumë e kufizuar’ por ‘nuk është në mënyrë të nevojshme një
9 pistë e duhur për të kundërshtuar konstatimet e Trupit Gjykses
10 në ushtrimin e diskrecionit të vetë për të vënë dhe për të
11 dalë me një vendim’”.

12 Një fragment i fundit që do të doja që të merrnit
13 parasysh, në poshtëshënimin 417, i cili ka të bëjë me çështjen
14 e apelit të TPNJ-së kundër Slobodan Millosheviçit, ku në
15 vendimin për apelin e ndërmjetëm të procedurave të
16 mospërfilljes së Gjykatës së Kosta Bulatoviç, u tha më poshtë:

17 “Dhomat e Apelit nuk janë të bindura që rrethanat e
18 ankimesit duhet të krahasohen me rrethanat e të akuzuarve të
19 tjerë, të cilët janë dënuar për mospërfillje të Tribunalit.
20 Dhe gjykimet, në raste të tilla, do të duhet të merren mbi
21 bazën e meritës dhe themelit dhe rrethanat individuale të
22 çështjes, kështu që Trupi Gjykses nuk është i detyruar që të
23 marrë parasysh një dënim të njëjtë që është dhënë për një
24 shpërfillje më të rëndë ose më pak të rëndë në një çështje
25 tjetër të ngjashme”.

1 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] A mund t'ju bëj një pyetje
2 këtu? A do thoni që konsistenca në dënim është një objektiv që
3 ne duhet të synojmë në një ambient të tillë, domethënë, në
4 gjykatat ndërkombëtare? Kjo është pyetja e parë. Dhe pyetja e
5 dytë është: A ka kufij, domethënë, ne biem dakord që çështjet
6 janë të ndryshme, por a ka kufij diskrecioni sa i takon
7 dënimit? Çfarë mendimi keni për këtë pyetje?

8 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit për pyetjen. Do filloj
9 me pyetjen për kufizimet dhe diskrecionin. Sa i takon kësaj
10 çështjeje, ne e kemi të qartë që Trupi Gjykses ka dhënë, pra,
11 dënime të ndryshme dhe pastaj ka dhënë një dënim të
12 përgjithshëm për të gjithë sjelljen kriminale të të akuzuarve.

13 Por, në rastin në fjalë, nuk ka pasur asnjë lloj abuzimi
14 me diskrecionin.

15 Dhe sa i takon me konsistencën e dënimit dhe, në qoftë se
16 ky duhet të jetë objektiv që duhet të arrihet, po, duhet të
17 ketë një lloj konsistence, të nderuar Gjykatës.

18 Diçka, që e anashkalon tërësisht Mbrojtja, është fakti
19 që, megjithëse në parashtrimet tona ne kemi dhënë arsye
20 logjike dhe konsistente të arsyes që pse Trupi Gjykses nuk ka
21 ndjekur dënimin që është dhënë në jurisprudencën e më
22 përparshme, megjithatë, do shikoni që është marrë parasysh
23 jurisprudenca e gjykatave të tjera.

24 Sa i takon parimeve që zbatohen, për shembull, për
25 faktorët lehtësues, rëndues, ashpërsisë së veprës penale,

1 gjëra të cilat janë marrë seriozisht parasysh nga Trupi
2 Gjykues dhe është kërkuar që të mund të kërkohej një lloj
3 konsistence e kësaj natyre. Duke mos ndjekur në mënyrë qorrazi
4 vendimin e jurisprudencës tjetër dhe, prandaj, ne arrijmë në
5 parashtrimin ose në pozicionin tonë që vendimi i Trupit
6 Gjykues është dhënë në përputhje në konsistencë me vendimet e
7 gjykatave të tjera, tribunalëve ndërkombëtarë.

8 Dje, Mbrojtja u mundua që t'i jepte një panoramë të
9 paplotë të veprimeve të të akuzuarve, përfshirë këtu, ajo
10 çfarë shikohet keqkuptim thelbësor të asaj çfarë nënkuptohet
11 nga zhvendosja e një individi.

12 Përderisa Mbrojtja në parashtrimet e veta është
13 përqendruar në çështje të tjera dhe aspekteve të cilat
14 pretendohen që janë të mangëta në këtë çështje, unë dua që të
15 sjell në vëmendjen tuaj disa elementë.

16 Në paragrafët 979 dhe 1004, për shembull, Trupi Gjykues
17 konsideroi që shpërndarja e paligjshme ishte bërë në masë të
18 gjerë që apellesit kishin përdorur platformën e organizatës që
19 përfaqësonin, që sjellja ishte e përsëritur dhe që kishin bërë
20 komente ndaj dëshmitarëve në frymën e përgjithshme të
21 frikësimit të dëshmitarëve dhe se kishte efekt potencial të
22 informacionit të mbrojtur të bëhej i ditur një numri të
23 konsiderueshëm personave.

24 Sa i takon çështjes së ndikimit, dua t'ju kujtoj
25 gjithashtu që një prej ekspertëve të vetë Mbrojtjes shpjegoi

1 që nuk bëhet fjalë për një dëshmitar të caktuar mbi të cilin
2 kanë ndikim veprimet e të akuzuarve, por ato çfarë kanë bërë
3 të akuzuarit kanë ndikim më të gjerë në komunitetin e
4 Mbrojtjes.

5 Argumenti i përsëritur dhe dje që Gucati e ka nxjerrë
6 informacionin e Mbrojtjes për median profesionale, gjë e cila
7 çon në rrezik të ulur dhe duhet të ishte reflektuar në dënim,
8 nuk qëndron, sepse ne mendojmë që "shpërndarja e informacionit
9 masiv është bërë pa bërë absolutisht asnjë lloj redaktimi
10 emrash apo një lloj nxjerrje selektive të informacionit".

11 Dhe këtu i referohem paragrafit 964 të aktgjykimit.

12 Dua që t'i drejtohem gjithashtu dhe znj. Myers,
13 dëshmitare e Mbrojtjes dhe dua të citoj atë çfarë tha ajo
14 "opcionin eksploziv ose opcionin i cili është më i vështirë
15 për t'u menaxhuar". Këtë mund ta shikoni në transkriptin e
16 seancës në datën 21 janar të këtij viti.

17 Mbrojtja ose ka injoruar ose ka harruar fakte që
18 konstatimet e veprimeve që kanë bërë ankimesit, "mund të
19 kishin efektin e parandalimit të ZPS-së që të përmbushte
20 mandatin e vetë dhe si rezultat viktimave të krimeve që janë
21 në juridiksionin e Dhomave të Specializuar do të ishte mohuar
22 e drejta e tyre ndaj të vërtetës dhe qasjes në drejtësi".

23 Ndërkohë edhe argumentet e dënimeve të tjera nuk kanë
24 arsyetuar ose mbështetur qëndrimin e Mbrojtjes. Për shembull,
25 në mënyrë të drejtë është folur për klimën e frikësimit të

1 dëshmitarëve. Haradinaj e keqpërfaqëson bazën për konstatime
2 të Trupit Gjykues në këtë aspekt dhe kjo parashtrohet në
3 paragrafin 165, 167 të dosjes përgjegjëse të ZPS-së.

4 Po ashtu, pra, ne mund të themi që në vendimin e Gjykatës
5 jepet një arsyetim dhe shtjellim i plotë sa i takon dënimit të
6 dy të akuzuarve.

7 Të nderuar Gjykatës, nuk ka pasur gabim të Trupit Gjykues
8 sa i takon dënimit.

9 Tani më lejoni që t'i drejtohem arsyes së pestë të
10 Haradinajt për apelim. Vendimi i Trupit Gjykues për sa i takon
11 mënyrave të përgjegjësisë penale nuk ka qenë i gabuar nga
12 Trupi Gjykues.

13 Palët kanë pasur qasje të barabartë ndaj aktakuzës,
14 ligjit dhe Kodit Penal të Kosovës, si dhe vendimit të
15 konfirmimit. ZPS-ja po ashtu e ka bërë të qartë që elementët
16 janë parashtruar në vendimin e konfirmimit dhe janë
17 identifikuar si bazë normative ose ligjore që ka të bëjë me
18 prezantimin e provave të veta.

19 Në përgjigjen e vetë Haradinaj pretendon që Trupi Gjykues
20 ka krijuar një "pritshmëri legjitime" që do të shqiptonte
21 veten, do të shprehej sa i takon elementeve të krimit si dhe
22 mënyrave të përgjegjësisë penale. Haradinaj nuk arrin që të
23 mbështesë këtë pretendim. Në fakt, gjatë dhënies së urdhrit me
24 gojë lidhur me parashtrimet me shkrim mbi elementët e veprave
25 penale dhe mënyrave të përgjegjësisë penale, drejtuesi i

1 Trupit Gjykues i urdhëroi palët që të bënin parashtrimet e
2 veta në qoftë se "ata dëshironin ta bënin këtë gjë". Kjo
3 gjuhë, nuk të çon në mënyrë të arsyeshme në pritshmëri
4 specifike legjitime sa i takon rezultatit dhe kohës.

5 Gjithashtu edhe sa i takon Arsyes 1 dhe Arsyes 2 edhe
6 këto nuk qëndrojnë. Dhe ndërkohë, në qoftë se të jep një listë
7 të vendimeve, kjo në vetvete nuk justifikon qëndrimin e
8 Mbrojtjes.

9 Ajo çfarë ndodhë është që, në fakt, Mbrojtja ka injoruar
10 faktin që Trupi Gjykues përbëhet nga gjykatës profesionistë.

11 Në qoftë se do t'i kthehemi Arsyes 1, Haradinaj pretendon
12 që ZPS-ja nuk e ka trajtuar siç duhet qëndrimin e vet ose e
13 argumenton mbi bazën e numrave. Megjithatë, nga ana tjetër nuk
14 jepet specifikisht se cili vendim gjyqësor është i padrejtë
15 apo se cila pjesë është e padrejtë.

16 Dhe këtë, në fakt, e dëgjuam edhe nga zoti avokat i
17 Haradinajt dje. Të nderuar Gjykatës, nuk keni nevojë që t'jua
18 them unë që dështimet e arsyetimit të pozicioneve të Mbrojtjes
19 nuk na takojnë neve, nuk jemi ne për t'u fajësuar për këto,
20 por është Mbrojtja për t'u përfaqësuar lidhur me këtë. Një
21 apel bëhet i paarsyetuar kur pala nuk mund të identifikojë
22 konstatime relevante të cilat mund të kundërshtojnë ose të
23 artikulojnë se çfarë është objekt i kundërshtimeve.

24 E nderuar Kryetare e Trupit Gjykues, ky është fundi i
25 parashtrimeve tona.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

2 Faleminderit.

3 [Anëtarët e Panelit të Apelit këshillohen]

4 Z. WHITING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nëse më
5 lejoni, kam një gjë për të shtuar plus asaj që tha z. Pace.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Po, kemi
7 kohë.

8 Z. WHITING: [Përkthim] Do t'ju marr vetëm një çast. Ka të
9 bëjë me përgjigjen që ka të bëjë me konsistencën.

10 Jam plotësisht dakord me atë që tha z. Pace, që sipas
11 këndvështrimit tonë, dënimi që është marrë për të akuzuarit
12 është plotësisht në përputhje me arsyetimin, qasjen dhe
13 logjikën dhe është në përputhje me jurisprudencën në çështje
14 të tilla të ngjashme për arsye të cilat ne i kemi parashtruar
15 dhe më parë.

16 Megjithatë, unë mendoj se është e rëndësishme gjithashtu
17 që të vërehet që parimi i konsistencës në dënim duhet të
18 lejojë gjithashtu edhe për rritje dhe zhvillim për sa i takon
19 të menduarit dhe marrjes së vendimeve. Pra, fusha ku operojmë
20 ne është shumë e re. Vetëm 25 vite ka që janë marrë vendime në
21 këto lloj çështjesh. Dhe ka pak çështje të cilat kanë me
22 pengimin e procedurave gjyqësore. Ne parashtrojmë, veçmas nga
23 argumenti që ne kemi parashtruar, në kuptimin që vendimi i
24 marrë është konsistent me atë çfarë ekziston deri tani, ne
25 plus kësaj parashtrojmë që ndoshta ka arsye për të vepruar

1 ndryshe, për shembull, duke marrë parasysh rrezikun që kanë
2 frikësimi apo bërja me dashje e veprimeve të tilla mbi të
3 tjerët, domethënë, është e rëndësishme që të shikojmë që cila
4 do jetë e ardhmja e këtyre çështjeve.

5 Mendoj që situata aktualisht është ndryshe nga çka qenë
6 25 vite më përpara, kjo është arsyeja që pse selia e kësaj
7 Gjykate është përcaktuar në Hagë, domethënë, një prej këtyre
8 arsyeve është frikësimi i dëshmitarëve. Dhe ndërkohë që ne
9 respektojmë parimin e konsistencës, mendojmë që duhet të kemi
10 mundësinë edhe të mendojmë ndryshe, mbase këto çështje kanë
11 nevojë për vendimmarrje për dënime të cilat janë më të rënda
12 krahasimisht me vendime të ngjashme që janë marrë në të
13 shkuarën.

14 Pra, ky është një plotësim që doja të bëja nga ajo çfarë
15 tha kolegu im në përgjigje të pyetjes që ju bë nga gjykatësi
16 Ambos.

17 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] A mund të bëj një pyetje sa
18 për të sqaruar. Domethënë, thjesht sa për argument, pra, mund
19 të kemi jurisprudencë që shkon në një drejtim tjetër, në
20 kuptimin që jepet një dënim më i rëndë për të njëjtën sjellje
21 dhe ju po thoni që mund të justifikojmë këtë sjellje më
22 serioze, sepse mund të thoni që, domethënë, siç e thamë, keni
23 vetëm 25 që kemi çështje të tilla, ju po thoni që duhet të
24 jemi më seriozë ose të japim dënim më të rëndë sa i takon
25 veprave të tilla. Por, konsistenca, për neve, në sistemet e

1 brendshme kombëtare, është një objektiv shumë i madh. Pra, kjo
2 është e vërtetë në fakt edhe në tribunalët ndërkombëtarë.
3 Kështu që ne nuk mund të bëjmë këtë lloj dallimi ndërmjet
4 sistemeve të brendshme juridike dhe tribunalëve ndërkombëtarë.

5 Besoj se jeni dakord me mua, nuk e mbrojmë dot një
6 pozicion kur themi që konsistenca është vlerë, megjithatë
7 konkretisht ose specifikisht neve mund të devijojmë nga
8 precedentët e vendosur më parë, sepse themi sot, në 2022, që
9 duhet që t'i shikojmë pak në mënyrë më strikte këto sjellje.

10 Z. WHITING: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Jam dakord
11 që konsistenca është e rëndësishme si për sistemin
12 ndërkombëtar dhe për sistemet e brendshme kombëtare ku kam
13 punuar dhe vetë. Është absolutisht e drejtë kjo qasje.
14 Megjithatë, nuk mund të ndodhë që të mos ketë mundësi për
15 rritje dhe për zhvillim dhe një rimendim, le të themi, të
16 sistemit për përcaktimin e dënimit.

17 Nuk mund të thuhet që çështjet e para në sistemin
18 ndërkombëtar të cilat ne shpresojmë që të vazhdojnë për dekada
19 apo shekujt në vijim, të mund të vënë vulën ose, le të themi,
20 të përcaktojnë tavanin sa i takon dënimeve për këto lloj
21 çështjesh edhe në të ardhmen. Pra, nuk mund të ndodhë që
22 vendimet e para të marra për çështje të ngjashme për këto 25
23 që, me thënë të drejtën, 25 janë një kohë shumë e shkurtër në
24 kuadrin e vendimeve të gjykatave ndërkombëtare, nuk mund të
25 themi që ky duhet të jetë tavan i përgjithmonë.

1 Besoj që duhet të kemi hapësirën që të mendojmë mbase.
2 Ndoshta, nuk e kemi menduar siç duhet këto çështje sa i takon
3 vendimmarrjes ose dënimit ose ndoshta qëllimi i dënimit nuk
4 është përmbushur për çështjet më përpara, kështu që mbase
5 duhet të ndryshojmë pak mënyrën sesi e mendojmë marrjen e
6 vendimit.

7 Pra, ajo çfarë po mundohemi të themi është që sigurisht
8 që nuk mund ta marrim vendimin bazuar në asgjë. Duhet të ketë
9 një vendim të arsyetuar. Megjithatë, unë parashtroj se ka
10 arsye të mjaftueshme që pengimi i proceseve gjyqësore apo
11 frikësimi i dëshmitarëve që janë pjesë e këtyre proceseve
12 gjyqësore, është një çështje shumë, shumë e rëndë, qëndron në
13 thelb të punës këtu dhe madje dhe për këtë arsye domethënë,
14 mund të mendojmë që ky është një problem edhe më i rëndë se
15 ç'ishte menduar në momentin kur janë marrë vendimet e para për
16 çështje si motra.

17 Për arsyet që parashtroi z. Pace dhe që ne i kemi
18 përfshirë në parashtrimin tonë, ju, besoj, që mund të dilni në
19 arsyetimin që vendimmarrja e marrë në këtë çështje është në
20 përputhje të plotë me vendimmarrjen në çështjeve e tjera.
21 Megjithatë, mendoj që ju lejohet juve, të nderuar Gjykatës,
22 dhe Trupit Gjyqësor që të mendoni që mbase vendimi duhet të
23 jetë pak sa më ndryshe. Edhe ndoshta këto lloj çështjesh duhet
24 të kenë vendime më të rënda sepse çështjet e pengimit të
25 drejtësisë ndodhin dhe një ndër qëllimet e vendimmarrjes ose

1 të gjykatave të tilla është që të ndërpritet një sjellje e
2 tillë në të ardhmen.

3 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Faleminderit. Duke marrë
4 parasysh edhe praktikën ose jurisprudencën e Kosovës,
5 gjithashtu, besoj? Sepse këtu nuk jemi në TPNJ. Mendoj apo nuk
6 jemi në Gjykatën Ndërkombëtare Penale sepse nuk mund t'i
7 vendosim në të njëjtën vend të gjithë tribunalët
8 ndërkombëtarë. Duhet të zbatojmë ligjin e Kosovës. Kështu që
9 në qoftë se duhet ta marrim seriozisht këtë gjë do të duhej që
10 të shikojmë praktikën e dënimit për çështje të ngjashme në
11 Kosovë.

12 Z. WHITING: [Përkthim] E kuptoj, i nderuar Gjykatës. Për
13 këtë arsye, unë them që këto janë parime të cilat janë të
14 zbatueshme si për jurisprudencën e brendshme ashtu edhe për
15 atë ndërkombëtare. Sa i takon sistemeve kombëtare, në të cilat
16 unë kam funksionuar [siç] edhe aty zbatohet i njëjti parim.
17 Pra, duhet të ekzistojë mundësia e zhvillimit dhe e rritjes
18 edhe sa i takon dënimit për akte apo sjellje të tilla.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
20 Faleminderit. Ky është fundi i parashtrimeve të Prokurorisë
21 për seancën e paradites.

22 Do të bëjmë një pushim. Dhe do të vijmë sërish në sallë
23 në orën 12 pa një çerek. Kur të vijmë, do të dëgjojmë
24 përgjigjet e Mbrojtjes, pra, Mbrojtjes së z. Gucati dhe z.
25 Haradinaj, të cilët të dy do kenë secili nga 20 minuta në

1 dispozicion. Faleminderit.

2 --- Pauza fillon në orën 11.18

3 --- Seanca rifillon në orën 11.48

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Tani më
5 lejoni t'i jap fjalën mbrojtjes të zotit Gucati që të
6 përgjigjet. Keni 20 minuta në dispozicion për këtë, zoti Rees.

7 Z. REES: [Përkthim] Dua që të falënderoj z. Cadman i cili
8 më tha që në qoftë se unë nuk kam përfunduar për 20 minuta,
9 mund të një pjesë të kohës së tij.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Si dje?

11 Z. REES: [Përkthim] Po, vërtetë. Si dje.

12 Do të mundohem që disa prej pikave t'i sjell me njëra-
13 tjetrën, pra t'i bashkoj. Megjithatë, e kuptoni të nderuar
14 Gjykatës që qasja e Prokurorisë trajtoi çështje të ndryshe në
15 kohë të ndryshme. Kështu që në vend që t'i përgjigjem paragraf
16 pas paragrafi, unë do të mundohem që disa prej pikave t'i
17 trajtoj bashkërisht.

18 Z. Whiting filloi duke pohuar, jo duke pretenduar, që
19 Mbrojtja ishte plotësisht në gjendje që të kundërshtonte
20 standardin dhe përmbajtjen e vërtetësisë së paketave.

21 Unë do të bëja këtë pyetje, se si mund ta bënim ne vënien
22 në pikëpyetje dëshminë e znj. Pumper, sa i takon identifikimit
23 të dëshmitarëve potencialë dhe dëshmitarëve dhe në fakt këtë
24 pyetje retorike e kemi bërë edhe më përpara dhe nuk kemi marrë
25 një përgjigje ndaj kësaj pyetjeje nga ZPS-ja as sot dhe as në

1 dosjen me shkrim.

2 Shembuj të disa prej dokumenteve të kufizuara të cilat
3 janë nxjerrë në mënyrë të redaktuar që u treguan sot nga z.
4 Pace nuk përmbajnë mjete, për shembull, të identifikimit të
5 një personi i cili në formulimin ose fjalët e ZPS-së, i
6 referohet çdo personi i cili ka mundësi që të ketë informacion
7 për krimet, për kryesit apo krime të cilat janë në
8 juridiksionin e Dhomave të Specializuara. Pra, nuk ka asnjë
9 informacion që mund të na çojë ne në identifikimin ose
10 kundërshtimin që këto dokumente kanë identifikuar një person i
11 cili ka informacion për një krim për një person ose vepra
12 penale të cilat janë me interes për Dhomat e Specializuara.
13 Pra, është e pamundur që ta nxjerrim këtë informacion nga
14 shembujt që na u dhanë. Dhe në qoftë se një person i tillë
15 jepej me emër, nuk kemi informacion që ka të bëjë me numrat e
16 personave të tillë.

17 Sikurse e tha edhe z. Whiting, po, ka një prag sasior sa
18 i takon dëshmitarëve për sa i takon hakmarrjes dhe frikësimit,
19 dhe në veçanti pikës 3. Megjithatë, ne nuk sugjerojmë që nuk
20 ka një prag sasior. Por, ajo çfarë themi ne është që vetë
21 Trupi Gjykues e ka përdorur sasinë e emrave të dëshmitarëve
22 dhe dëshmitarëve potencialë, që pretendohet që janë
23 identifikuar nga znj. Pumper, si një tipar që shkoi, sipas
24 asaj që kanë thënë ata, për të vlerësuar nëse ka ekzistuar
25 *actus reus* ose akti penal. Megjithatë, në dosjen tonë të

1 procedurës paraprake, kemi bërë kritika. Domethënë, çështja
2 është që në qoftë si ti bën diçka që dikush të ketë frikë apo
3 shqetësim, kjo nuk do të thotë që ajo që ke bërë ti ka qenë
4 kanosje, apo kërcënim, sepse kanosja ose kërcënimi duhet të
5 behët me synimin që ti mund të shkaktosh dëmtim në të ardhmen.

6 Për shembull, në qoftë se dikush mund të ndezë një zjarr
7 në oborrin e tyre dhe ndoshta personi ose familja e cila është
8 komshi me familjen në fjalë, mund të ketë haurin e vet dhe kjo
9 mund të konsiderohet sikur kanoset nga familja tjetër, por
10 megjithatë nuk ka dashje në këtë pikë.

11 Një tjetër gjë është që Trupi Gjykses përdori numrat dhe
12 provat e znj. Pumper si pjesë e vlerësimit në qoftë se
13 ekzistonte *actus reus* dhe kjo e gabuar. Trupi Gjykses ka
14 gabuar në këtë pikë, sepse nxjerrja, sa i takon informacionit
15 që do të na lejonte ne ta kundërshtonim këtë pretendim nuk na
16 është vënë në dispozicion. Standardet për nxjerrjen e
17 materialeve të paketave në tërësinë e tyre janë përmbushur
18 sipas Trupi Gjykses, dhe Trupi Gjykses ka identifikuar që
19 materiali duhej të ishte nxjerrë ose sipas rregullës 102(3)
20 apo 103. Pastaj vjen rregulla 108, që parashikon që ka arsye
21 për kufizimin e nxjerrjes së materialeve.

22 Megjithëse në një kuptim të përgjithshëm ne e kritikojmë,
23 e kemi kritikuar më parë dhe vazhdojmë ta kritikojmë sot këtë
24 vendim, sepse ne kemi kërkuar nxjerrjen e materialeve.
25 Gjithsesi këtu jemi, në procedurën e apelit. Domethënë unë jam

1 i shqetësuar për të ngritur çështje të cilat kanë të bëjnë me
2 sigurinë e dënimit. Duke mos [e pakuptueshme] "sigurinë" në
3 kontekstin teknik, sepse kjo nuk është pjesë e një dënimi, por
4 në kuptimin e zhvlerësimit të dënimit ose të cenimit të
5 drejtësisë.

6 Pra, ne mendojmë që një qasje më e drejtë duhet ta kishte
7 kufizuar Prokurorinë dhe çështjen e vet lidhur me atë se çfarë
8 duhej të nxirrej. Dhe kjo nuk ka ndodhur, kështu që Trupi
9 Gjykues në mënyrë të padrejtë e lejoji ZPS-në që të thërriste
10 Zdenka Pumperin të jepte dëshmi për nxjerrjen e dokumente duke
11 ofruar përpara Trupit Gjykues analizën e vet në qoftë se një
12 faqe e caktuar kishte identifikuar një dëshmitar ose dëshmitar
13 potencial, pa dhënë prova në qoftë se personat e identifikuar
14 prej saj ishte informacion që kishte të ngjarë që të kishte
15 informacion për një krim, kryesin, ose vepra penale që janë me
16 rëndësi për Dhomat e Specializuara. Megjithatë, ajo tha,
17 pavarësisht që nuk kishte asnjë informacion lidhur me sa
18 thashë më sipër, që kjo faqe identifikonte jo vetëm një
19 person, por iks numër personash. Dhe pastaj Trupi Gjykues u
20 mbështet në shifrat që kishte përmendur ajo, pavarësisht që ne
21 nuk i kemi parë fare këto dokumente. Kështu që ne themi që kjo
22 shkon në favor të vërtetimit të një kanosje ose të rrezikut, i
23 cili është i pabazë.

24 Z. Whiting iu referuar shtytjes në kryerjen e veprës
25 penale. Pra, përdori fjalë në vend të njëra-tjetrës, pra

1 "shtytje", "nxitje" dhe "shtytje në vepra penale, pra unë nuk
2 është se kam ndonjë problem. Në fakt në përdorimin e këtyre dy
3 termave në vend të njëra-tjetrës, sepse Remanauskas është
4 jurisprudenca mbështetëse dhe në fakt kemi një vendim të
5 Dhomës së Madhe që e jep qasjen e saj sa i takon shtytjes në
6 kryerjen e veprës penale, dhe aty u përmend shtytja në
7 kryerjen e veprës penale nga një polic. Megjithatë, një gjë që
8 nuk është thënë asgjëkund në jurisprudencë për sa i takon
9 shtytjes në vepër penale ose nxitje, pa diskutii kjo nuk është
10 e parashikuar në çështjen Remanauskas. Megjithatë, nuk
11 përdoret fjala "detyrim", ose në qoftë se i pandehuri është i
12 detyruar me forcë ose i shtrënguar dhe këto në fakt nuk janë
13 të parashikuara asgjëkund në teste ose standardet juridike për
14 shtytjen e kryerjes së veprës penale ose në nxitjen. Ata
15 përdoren nga ZPS-ja ndërkohë që nuk ekziston absolutisht asnjë
16 jurisprudencë pas këtij propozimi të tyre.

17 Në fakt ZPS-ja është munduar ta bëjë këtë gjë në proces
18 gjyqësor dhe sigurisht kjo është diçka që Trupi Gjyqësor me të
19 drejtë e rrëzoi, duke vënë re në paragrafin 858 të gjykimit,
20 që ka veprime predispozite. Megjithatë, nga ana tjetër, kjo
21 nuk është se përjashton mundësinë e shtytjes për kryerjen e
22 veprës penale.

23 Pra ajo çfarë kërkohet, siç thuhet në çështjen
24 Ramanauskas, është ndikimi dhe efekti i ndikimit.

25 Nëse më lejoni, të nderuar Gjykatës, për një çast.

1 Ushtrimi i një ndikimi të tillë, që çon në kryerjen e një
2 veprë penale, e cila për ndryshe nuk do të ishte kryer, në
3 mënyrë që ta bëjë të mundur vërtetimin e veprës penale dhe të
4 duhet që të jepen prova nga Prokuroria.

5 Domethënë ky është standardi. Nuk është e nevojshme që të
6 vërtetohet detyrimi. Domethënë, në qoftë se konstatohet
7 ushtrimi i ndikimit, kjo në vetvete është e mjaftueshme,
8 pavarësisht natyrës që mund të ketë një ndikim i tillë dhe
9 pavarësisht nga fakti në qoftë se personi i ndikuar është i
10 predispozuar apo jo për të kryer një krim të tillë.

11 Për shembull, një oficer policie, nëse ai jep mjetet për
12 të kryer një veprë penale dhe e nxit dikë që të bëjë një veprë
13 penale, atëherë në këtë rast kemi të bëjmë me një rast klasik
14 të shtytjes në kryerjen e veprës penale. Nuk është e nevojshme
15 që subjekti në fjalë të jetë i detyruar që të ketë bërë këtë
16 veprim. Megjithatë, përkufizimi është ky, pra, shtytja në
17 kryerjen e veprës penale.

18 Tani do të sugjeroja që të shohim disa prej çështjeve që
19 kanë të bëjnë me interpretimin ligjor. Gjithsesi, interpretimi
20 ligjor nuk është i zbatueshëm për shtytjen në kryerjen e veprës
21 penale, sepse ky është një standard i cili është marrë nga
22 çështja Ramanauskas, nuk është se ka dispozita ligjore
23 shprehimisht të thëna sa i takon këtij termi.

24 Megjithatë, do kaloj te disa interpretime të dispozitave
25 ligjore. Për shembull, propozimi që kemi dhënë -- le të themi

1 interpretimin e dispozitave ligjore që nuk janë marrë ose nuk
2 janë bërë nga gjykatësit në këtë çështje, dhe interpretimi nuk
3 është i saktë sepse dihet që të dy të akuzuarit nuk janë
4 dënuar për pikën 4 dhe z. Halling e di shumë mirë këtë gjë.
5 Prokuroria thotë që ka një bazë ligjore sa i takon frikësimit
6 dhe kjo rrjedh nga gjykatat e Kosovës që tregon që
7 interpretimi ynë nuk është ndjekur nga Gjykatat e Kosovës. Dhe
8 ata i referohen dy çështjeve të cilat janë në shkallë të parë
9 gjykimi dhe në fakt, këto nuk janë vendime përfundimtare sepse
10 ne këtu jemi, para Gjykatës së Apelit dhe ju nuk jeni të
11 detyruar që të merrni si pikë reference dy vendimet të
12 shkallës së parë nga Gjykatat e Kosovës. Pra, nuk ekziston një
13 bazë, një jurisprudencë mbi këtë pikë dhe nga ana tjetër kemi
14 dispozitën 310 të Kodit të Përkohshëm që në terma identike,
15 domethënë cilësuesi këtu është krimi i organizuar dhe ne të
16 gjithë jemi dakord me parashikimin e 310-ës dhe e vetmja gjë
17 që zëvendësohet në nenin 387 është "pengimi i procedurave"
18 penale, pra në vend të "krimit të organizuar" që parashikohet
19 në nenin 310.

20 Lidhur me faktin në qoftë se emrat ishin të mbrojtur në
21 dokumentacionin përkatës që u ngrit nga z. Halling, dosja jonë
22 e apelit, në paragrafin 234 dhe në vijim, e trajton këtë
23 çështje. Është arsyeja 8(b) e njoftimit tonë për apel.

24 Ankesa jonë përfshin, nuk është vetëm e kufizuar, por
25 përfshin faktin që Trupi Gjykses ka konsideruar nenin 35(2)(f)

1 të Ligjit të përgjithshëm të Dhomave të Specializuara, dhe
2 rregullën 30(2) (a) të Rregullores, si bazën për pozicionin apo
3 qëndrimin e ZPS-së që të gjithë emrat që përmenden në një
4 dokument janë emra të mbrojtur.

5 Ata thonë që në fakt, Prokuroria ka ushtruar kompetencat
6 e veta, mbështetur në dispozitat ligjore.

7 Neni 30(2) (f) parashikon që përgjithësitë e ZPS-së
8 përfshijnë marrjen e masave të nevojshme ose kërkimit që të
9 merren masat e nevojshme për të siguruar konfidencialitetin e
10 informacionit, mbrojtjen e personave ose ruajtjen e provave.
11 Si rezultat, masat për mbrojtjen e personit janë konkretisht
12 të nevojshme për t'u marrë, në mënyrë që të ushtrohen.
13 Domethënë, nuk zbatohen *per se*, pra duhet që masat të merren,
14 pra duhet të ketë ushtrim të kësaj kompetence.

15 Nuk kemi konfidencialitet *ipso facto* që zbatohet mbi të
16 gjithë personat të cilët përmenden në dokumentet e
17 Prokurorisë, në kundërshtim me pretendimin e Prokurorisë dhe
18 në të vërtetë ne parashtrojmë që kjo është konstatuar gabim
19 edhe nga Trupi Gjykyes, pra vetëm ato masa të cilat janë të
20 nevojshme për autoritetin e Prokurorit të Specializuar, mbi
21 bazën e nenit 30(2) (f), pra masat të cilat nuk janë të
22 nevojshme. Për shembull, trajtimit të çdo emri në çdo dokument
23 të Prokurorisë për çdo arsye, si konfidenciale, kjo në vetvete
24 është një masë e panevojshme dhe si rezultat është e
25 paautorizuar sipas dispozitave ligjore.

1 Rregulla 30(2) (a) në të njëjtën mënyrë parashikon se ZPS-
2 ja duhet të sigurojë sigurinë e viktimave dhe personave të
3 tjerë që janë në rrezik, mbi bazën e informacionit që i është
4 dhënë ZPS-së. Është e qartë që Mbrojtja nuk i jepet
5 automatikisht çdo personi që jep informacion ose që
6 bashkëpunon me ZPS-në, por është informacion i cili i
7 referohet personave që janë në rrezik për shkak të bërjes së
8 kësaj gjëje.

9 Pra, neni 30(2) (a) deri në (f) kërkon vlerësimin e
10 rrezikut të në personi që ka dhënë informacion ose ka ofruar
11 bashkëpunim me ZPS-në dhe nevojën e masave mbrojtëse që kanë
12 të bëjnë me individin në fjalë.

13 Në rastin në fjalë, në çështjen në fjalë, Trupi Gjykses
14 në fakt nuk dëgjoi asnjë provë që kishte të bënte me
15 vlerësimin individual të rrezikut, nuk dëgjoi asnjë provë që
16 kishte të bënte me nevojshmërinë e marrjes së këtyre provave
17 sepse ne nuk e kishim idenë se kush ishin këta. Nuk kishim
18 asnjë informacion se çfarë dijeni kishin, apo çfarë lloj
19 vlerësimi ishte bërë lidhur me këta persona. Ky është një
20 tjetër shembull i padrejtësisë së procedurës gjyqësore dhe
21 lejimi i dhënies së dëshmisë së znj. Pumper sa i takon
22 nxjerrjes së dokumenteve, arsyetimit të mosnxjerrjes së
23 dokumenteve nga ZPS-ja.

24 Atëherë, po ndjek rendin e parashtrimeve me gojë të
25 Prokurorisë, kështu që më lejoni që t'i kthehem edhe një herë

1 shtytjes për kryerjen e veprës penale. Siç e kuptoj, ZPS-ja
2 tani e pranon se pragu jo i pamundur është më pak se pragu [e
3 pakuptueshme], megjithatë, atë e ka përdorur Trupi Gjykses.
4 Është pyetje e cila është bërë disa herë dhe si z. Whiting dhe
5 z. Halling e identifikuan këtë si prag minimum. Megjithatë,
6 kjo nuk të ndihmon fare, lidhur me atë se çfarë është
7 standardi që ka zbatuar Prokuroria, po thjesht thanë që është
8 standardi ose pragu minimal.

9 Megjithatë, ne nuk mendojmë që Ramanauskas Nr. 2 për t'ju
10 referuar ilustrimit elokuent të z. Halling, është një çështje
11 kampion, çështje kryesore e përdorur nga Mbrojtja. Ne mendojmë
12 që nuk është vetëm e jona si çështje kampioni ose si çështje
13 reference, por duhet të jetë çështje e tillë në të gjitha
14 çështjet me të njëjtën natyrë. Sigurisht, ajo çfarë është e
15 detyrueshme dhe ajo çfarë është çështja drejtuese, është
16 Ramanauskas Nr. 1 sepse Dhoma e Madhe ka përcaktuar se cilët
17 janë elementët e shtytjes në kryerjen e një vepre penale në
18 mënyre shumë të qatë.

19 Nëse do kaloj te dënimi. Z. Pace i referohet çështjes
20 Margetiç, pra, paragrafin 88, si shembull të dallimit midis
21 fakteve në çështjen Margetiç dhe çështjes që kemi ne në
22 gjykim. Pra, në këtë kuadër, Z. Pace thotë që pavarësisht që
23 Z. Margetiç e kishte botuar një listë prej 102 individëve, pra
24 të listave të plota të dëshmitarëve dhe e kishte bërë këtë
25 pavarësisht që ishte paralajmëruar paraprakisht që të mos e

1 nxirrte, të mos e botonte informacionin e mbrojtur, në kohën e
2 gjykimit në çështjen në fjalë ai nuk kishte dëshmuar të
3 njëjtin qëndrim që kishte pasur më përpara, pra, domethënë nuk
4 kishte vijimësi të qëndrimit të tij të mëparshëm. Kjo mund të
5 thuhet në konstatimet e Trupit Gjykses që të jetë dallimi
6 ndërmjet çështjes Margetiç dhe çështjes në fjalë. Megjithatë,
7 besoj që i keni parë edhe vetë, zotërinj Gjykatës, që
8 gjithsesi dallimi ndërmjet dy çështjeve nuk mund të shërbejë
9 si justifikim për ndryshimin e dënimit në çështjen Margetiç
10 dhe dënimin me katër vjet e gjysmë të të akuzuarve në çështjen
11 për të cilën jemi mbledhur këtu.

12 U referua gjithashtu edhe çështja 88. Mund të thuhet, ose
13 mund të shihet që në çështjen Al Khayat vendimi i marrë ishte
14 tërësisht në konsistencë me vendimet e tjera që ishin marrë në
15 të njëjta natyra çështjesh. Pra është e pamundur që të gjesh
16 një çështje tërësisht identike dhe megjithatë, pavarësisht
17 dallimeve midis çështjeve, dënimi ka qenë konsistent. Pra, për
18 sa i takon shkallës së dënimit, ka pasur konsistencë ndërmjet
19 çështjeve në jurisprudencën ndërkombëtare që unë ju përmenda
20 më përpara.

21 Sa i takon Miloshviçit, në çështjen Milosheviçit, te
22 pjesa e vendimeve në këtë çështje, nuk mendoj se ja vlen të që
23 ta trajtojmë këtë çështje se s'e besoj që pozicioni i ZPS-së
24 është i qartë, i shprehur si nga Z. Pace, dhe i konfirmuar nga
25 z. Whiting, që ata e pranojnë të dy që konsistenca në vetvete

1 është një parim i rëndësishëm që Trupi Gjykses duhet që t'i
2 kishte parë më me shumë seriozitet këto dënime që ishin marrë
3 në jurisprudencën e mëparshme dhe duhet të kishte demonstruar
4 konsistencë në vendimin e tyre.

5 Sigurisht që e drejta e tyre për ta pranuar në këtë fazë
6 të vonë të procesit gjyqsor, nuk është e diskutueshme, nuk ka
7 qenë asnjëherë e diskutueshme, megjithëse ka pasur një
8 përpjekje me gjysmë zëri për ta kundërshtuar këtë, që do ta
9 trajtoj në fund të fjalës time.

10 Megjithatë, është e përcaktuar në çështjen Strugar që në
11 çështje të natyrave të tilla, duhet që të merret parasysh
12 konsistenca dhe duhet që t'i kushtohet rëndësi mos vendosjeve,
13 ose pa përputhshmërive ndërmjet dënimeve që merren në çështje
14 të ndryshme. Pra, duhet që në qoftë se ka dallim vendimi,
15 duhet që të merret parasysh parimi i proporcionalitetit.

16 Dua që të ndaloj pak sa i takon dënimit ose asaj çfarë
17 parashikohet në dispozitat ligjore, në pjesën e vendimit që ka
18 të bëjë me çështjen Strugar. Pra, në përmbledhje në këtë
19 çështje paracaktohen kërkesa për konsistencë, domethënë, së
20 pari pranohet që asnjëherë nuk do të ketë dy çështje që do
21 jenë identike me njëra-tjetrën, kështu që nuk ja vlen fare që
22 të kërkojë dy çështje që janë identike dhe nga ana tjetër, sa
23 i takon komentit të z. Whiting për rritje dhe zhvillim për
24 vendimet e dënimit, ato nuk qëndrojnë, sepse kemi të bëjmë me
25 gabime të cilat lidhen me vendime jo përpjesëtimore, domethënë

1 nuk janë në raport me vendimet e përcaktuara në bazën ligjore
2 për vepra të kësaj natyre.

3 Dhe parashtrimi ynë është që saktësisht e njëjta gjë ka
4 ndodhur në çështjen tonë.

5 Më lejoni të trajtoj një çështje faktike. Kuptimi ynë i
6 provave të z. Myers, për sa i takon sinjalizueses së
7 drejtësisë dhe përmendjes së opsionit bërthamor të saj, që
8 ishte opsioni kur ti i bën informacionet publike, ajo iu
9 referuar sinjalizuesëve që e botonin materialin në mënyrë të
10 drejtpërdrejtë vetë. Për shembull, kur këta e fusin në faqen e
11 tyre të internetit ose për shembull e hedhin në internet.
12 Domethënë, pak a shumë e njëjta gjë si kjo që bëri z.
13 Margetiç. Ajo çfarë bëri z. Margetiç është që në faqen e tij
14 të internetit e botoi të gjithë informacionin e mbrojtjes. Pra
15 ju referua sinjalizuesëve që shkojnë tek anëtarët e medias
16 profesionale dhe e shpjegoi këtë si një opsion më pak të rëndë
17 sepse gazetarët kanë parasysh përgjegjësit e tyre etike dhe
18 standardet etike. Domethënë, këtë e pa si një alternativë të
19 ndjeshme, jo si opsionin bërthamor.

20 Pavarësisht kësaj, ajo çfarë dua të sjell në vëmendje,
21 lidhur me materialin që është zbuluar apo është nxjerrë,
22 kryesisht mediat te profesionale, domethënë ky l konstatim i
23 Trupit Gjykses, nuk është se është ndonjë pretendim i yni.
24 Është konstatim i vendimit të Trupit Gjykses, që ne e kemi të
25 parashikuar në - që mund ta lexoni edhe në paragrafin përkatës

1 të vendimit për procesin gjyqësor.

2 Pra, tentimi për të shkuar paralelisht në dy pista që
3 janë në kundërshtim me njëra-tjetrën, që e vumë re nga z.
4 Halling edhe për të pranuar parashtrimet e z. Pace, por nga
5 ana tjetër edhe për t'i kundërshtuar ato në të njëjtën kohë, u
6 tha që ka vetëm 25 vite dënimi. Pra, ndërkohë, kundër-
7 argumenti im është që është 25 që janë marrë vendime për
8 çështje të tilla, domethënë nuk është se ka ndodhur dje. Ka
9 kohë goxha të konsoliduar sa i takon vendimmarrjes. Ai tha që
10 ndoshta njerëzit mendojnë ndryshe sot, krahasimisht me çfarë
11 kanë menduar më përpara për vepra të tilla. Ndoshta mund të
12 jetë kështu, ndoshta mund të mos jetë kështu. Unë do ju
13 kërkoja ju, të nderuar Gjykatës, që të mos përfshiheshit nga
14 retorika, por të shikonit në fakt çfarë kanë përcaktuar dhe
15 çfarë parashikon juridiksioni -- jurisprudenca, lidhur me
16 çështje të natyrave të ndryshme.

17 Në përmbledhjen e dënimit që kemi ofruar, në fakt data më
18 e hershme është viti 2005, por ata përfshijnë tetorin e vitit
19 2015, që është çështja Al Khayat, që është çështja që përmend
20 Prokuroria. Kjo është e përfshirë, domethënë kjo është një
21 çështje për të cilën është marrë thjesht një gjobë, vendimi
22 është me gjobitjen e aplikantit.

23 Ndërkohë pastaj kemi dokumentin tjetër, apo
24 jurisprudencën, Al Amine, 2016. Pra, sërish kemi të bëjmë me
25 një vendim për një gjobë për një person i cili ka identifikuar

1 material të rëndësishëm, dhe fotografitë, apo hollësi të
2 tjera. Domethënë të 17 dëshmitarëve --

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Z. Rees,
4 keni kaluar, keni edhe pesë minuta kështu që thjesht doja t'ja
5 u sillja në vëmendjen tuaj këtë gjë.

6 Z. REES: [Përkthim] Nuk kam shumë minuta në dispozicion,
7 megjithatë, siç ramë dakord me z. Cadman, mund ta zgjas një
8 çikë më tepër ndërhyrjen time, apo jo z. Cadman?

9 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Po.

10 Z. REES: [Përkthim] Pra 17 dëshmitarë, fotografi, detaje
11 të botuara, pra kemi gjithashtu edhe një nen të dytë, që janë
12 nxjerrë të dhënat e 15 dëshmitarëve të tjerë dhe në këtë rast,
13 i është referuar vendimit gjyqësor, frikërave të dëshmitarëve
14 dhe numrave të lartë të dëshmitarëve. Pra, në këtë rast, në
15 fakt, është marrë vendimi nga Gjykata për 25 mijë Euro gjobë,
16 dhe sërish ky është një vendim i vitit 2016 dhe nuk është
17 ndonjë vendim i marrë shumë e shumë vite më parë.

18 Tani, vijmë edhe më pranë, në një dispozitë tjetër, në
19 një jurisprudencë tjetër, që është më e afërt me vitin 2022.
20 Është çështja e vitit 2012, që është marrë vendimi me heqje
21 lirie për dy vjen në çështjen Sheshelj, i cili ishte dënuar
22 për dy herë të mëparshme, për dy vepra të tjera penale, pra
23 kishte refuzuar që të hiqte nga faqja e tij e internetit
24 informacionin që kishte të bënte me nxjerrjen e dëshmitarëve
25 të mbrojtur. Personi në fjalë ishte urdhëruar që të kalonte 18

1 muaj -- këto ishin dënimet e mëparshme për vepra penale të
2 mëparshme, përfshirë këtu edhe kopjimin e rreth 10 mijë faqe
3 libri të cilat kishin të bënin me informacion të dëshmitarëve
4 të mbrojtur. Pra, kjo është një shpërfillje flagrante ndërkohë
5 që TPNJ vendosi për zotërinë në fjalë vetëm dy vite heqje
6 lirie dhe Dhoma e Apelit në vitin 2013 e la në fuqi të njëjtin
7 nivel dënimi për të akuzuarin.

8 Të njëjtin vit, pra u vendosën 12 muaj heqje lirie në
9 çështjen Rasiç, ku i pandehuri në këtë rast i dha ryshfet një
10 dëshmitari, në mënyrë të tillë që të jepte një dëshmi të
11 rreme. Dhe i ofroi këtij dëshmitari që të kalonte ryshfete të
12 tjera për persona të tjerë, që të jepni dëshmi të rreme. Pra,
13 këto ishin rrethanat e çështjes, ndërkohë që zonja, kam
14 përshtypjen që e dënuara ishte zonjë, pra në rastin në fjalë
15 u vendosën 12 muaj burgim. Dhe në kohët më të fundit, në vitin
16 2018, çështja Bembe Gombo, që është çështje e 17 shtatorit të
17 vitit 2018, ku i akuzuari dënohet pas procesit gjyqësor për
18 nxitjen e dëshmisë së rreme për 14 dëshmitarë të mbrojtjes.
19 Prokuroria në atë rast kërkoi 5 vjet dënim me burgim duke u
20 mbështetur në të njëjtin argument që dha z. Whiting sot këtu.
21 Domethënë, dëshmitarët dhanë dëshmi të rreme, pra kishim të
22 bënë me një proces prej tridhjetë [sipas përkthimit] muajsh
23 të paktën, domethënë bëhej fjalë për të akuzuar që ishin goxha
24 kishin plan shumë të detajuar dhe planin jo vetëm që e kishte
25 në mendje planin, por plani ishte ekzekutuar. Domethënë, me

1 fjalë të tjera, në çështjen në fjalë bëhet fjalë për shumë
2 dëshmitarë të përfshirë, kishim të bënim me një plan të
3 organizuar, domethënë kishim të bënim gjithashtu edhe me
4 dinamikën e shtrëngimit të grupit. Fushëveprimi ishte i gjerë,
5 planifikimi dhe ekzekutimi ishin ashtu fakt, kështu që në
6 rastin në fjalë, u përfshinë edhe rrethana rënduese, dhe u mor
7 parasysh edhe pozicioni dhe roli që kishte luajtur Bemba.

8 Në rastin në fjalë, Prokuroria kërkoi pesë vite burgim,
9 që u rrëzua si kërkesë dhe në fakt vendimi i marrë ishte
10 vuajtje dënimi, ose burgim 12 muaj dhe gjobë me 300,000 euro.
11 Pra në rastin në fjalë, kishim të bënim me një person i cili
12 përfshinte shumë dëshmitarë. Pra bëhej fjalë për një çështje
13 tjetër, për një gjeneral, që kishte marrë pjesë në krimin e
14 Serbrenicës dhe në vrasje apo në vepra të tilla të rënda, pra,
15 mbështetur në një sërë vendimesh të TPNJ-së.

16 Megjithatë, mund të kalojmë edhe në vendime më të vona.
17 Për shembull, në mekanizmin e çështjeve të mbetura. Është
18 çështja Ngirabatware, që me 25 qershor të vitit 2021 Gjykatësi
19 i Vetëm vendosi në lidhje me dënimin pas gjykimit, një vendim
20 për heqjen lirie 2 vjet. Ngirabatware ofroi që të shpërblente
21 shumë persona, mijëra e mijëra euro ishin paguar ryshfete.
22 Bëhet fjalë për një përpjekje shumë të organizuar, si qëllim
23 kryesor kishte të ndryshonin rrjedhën e dënimit të z.
24 Ngirabatware për gjenocid.

25 Pra, në rastin në fjalë, kishte ndërhyrje, domethënë

1 ish-in persona të cilët ish-in paguar për të dhënë dëshmi të
2 rreme dhe ky ryshfet ishte në 6 milionë franga nigeriane.
3 Rrethanat ish-in të qarta, ndërkohë që kishte hollësi sa i
4 takon rrethanave për vendimin e tyre për të nxjerrë të
5 pafajshëm gjeneralin, ndërkohë që dëshmitarët kanë gënjyer
6 përpara Trupit Gjykues. Domethënë, është çështja në fjalë.
7 Thjesht dëshmitarët kanë lexuar skriptin e shkruar prej të
8 tjerëve. Pra, i gjithë qëllimi ishte që të mos dënohej
9 gjenerali dhe si rezultat çështja kaloi në apel. Në mënyrë të
10 vazhdueshme personi kishte ndarë informacion konfidencial ose
11 përmbajtje të dosjeve konfidenciale, duke e ditur ose duke
12 qenë në dijeni të faktit që po shkelte masa specifike
13 mbrojtëse.

14 Prokuroria në çështjen në fjalë, siç u përpoq edhe z.
15 Whiting të bënte sot këtu, e kundërshtoi këtë. Pra, kërkuam
16 heqjen e lirisë ose burgosjen shtatë vjet të z. Ngirabatware
17 duke thënë që i akuzuari ishte i përfshirë në një skemë të
18 paprecedentë dhe duke thënë se personi ishte dënuar për
19 gjenocid dhe pavarësisht se ai kishte mundësi që të mund të
20 organizonte këtë skemë të sofistikuar për tjetërsim ose
21 prapësim të dënimit të tij. Dy vite vendosi mekanizmi, duke e
22 kundërshtuar pozicionin e Prokurorisë, që siç e thashë më
23 sipër, kërkoi 7 vjet heqje lirie për zotërinë në fjalë.

24 Sigurisht që kjo çështje i është bërë me dije edhe Trupit
25 Gjykues dhe përsëri me 29 qershor të vitit 2022 Prokuroria e

1 apeloj vendimin e marrë për Ngirabatware, domethënë e apeloj
2 vendimin e marrë për Ngirabatware, domethënë e kundërshtuan
3 këtë çështje duke përdorur argumentin që ndoshta po mundohet
4 të përdorë z. Whiting në këtë çështje. Prokuroria e apeloj,
5 dhe Dhoma e Apelit në qershor të këtij viti, të vitit 2022, e
6 hodhi poshtë këtë apel dhe e la -- pjesa më e madhe vendosën
7 që 18 muaj ishte dënimi përkatës ose dënimi me vend për
8 personin në fjalë. Domethënë thjesht bëhej fjalë për dy muaj
9 diferencë. Ne e parashtruam këtë përpara Trupit Gjykses,
10 megjithatë Trupi Gjykses nuk e mori parasysh këtë gjë.
11 Megjithatë, Dhoma e Apelit e mekanizmit tha që kishte
12 vështirësi të veçanta në faktin që Ngirabatware kishte qenë në
13 paraburgim në kuadrin e pandemisë globale dhe si rezultat nuk
14 kishte pasur kontakte me familjarët ose me miqtë dhe e
15 konstatoi këtë si një element të rëndësishëm për t'u marrë
16 parasysh në përcaktimin e dënimit. Pra, këto janë dënime dhe
17 kjo është jurisprudenca që ekziston në këtë fushë. Megjithatë
18 kjo nuk është jurisprudencë e cila është e vjetër, ndryshe siç
19 u pretendua nga Prokuroria, është një jurisprudencë e kohëve
20 të fundit. Është nga Tribunalë të shumtë ndërkombëtarë dhe nuk
21 ka meritë apo nuk ka mbështetje, nuk ka arsyetim për t'u
22 larguar nga konsistenca që vërehet në të gjitha këto çështje
23 që unë ju përmenda nga jurisprudenca ndërkombëtare.

24 Nuk e di se ku e gjen Prokuroria këtë lloj konsistence,
25 megjithatë parashtrimi ynë është që këto konstatime do të

1 duhen të merren parasysh në të gjitha pikat dhe ne do kërkojmë
2 që koha e burgimit duhet patjetër që të ulet, sepse të gjitha
3 vendimet që unë citova deri tani janë vendime që parashikojnë
4 dënime shumë më të vogla se sa kaq dhe mendojmë që duhet që të
5 merret parasysh elementi i proporcionalitetit këtu.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]
7 Faleminderit z. Cadman. Pesë minuta kohë ju kanë ngelur.
8 Shpresoj t'ju mjaftojë.

9 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Uroj që të mos
10 flas shumë shpejt për përkthyesit. Do përpiqem t'i kaloj sa më
11 shpejtë pikat që kam, ka disa çështje që dua t'i trajtoj por
12 dua t'i kaloj shumë shpejt.

13 Pika e parë që dua të ngre për t'iu përgjigjur pyetjes së
14 Gjykatëses Jorgensen, lidhur me çështjen -- referencën që
15 përdora unë sa i takon provave para gjykatësit të Trupit
16 Gjykues dhe në qoftë se Mbrojtja -- në qoftë se kjo në mënyrë
17 të pashmangshme solli një cenim apo një shkelje të nenit 6.
18 Kjo ishte çështja Edwards dhe Lewis.

19 Pika e dytë që doja të ngrija unë ishte pyetja që ngriti
20 Gjykatësi Ambos, po dje. Pasi pata mundësinë të shikoja
21 transkriptimin mbrëmë, sepse siç e kuptuat unë dje kisha pak
22 vështirësi me lidhjen dhe kisha pak probleme me përqendrimin
23 dje. Por dua t'ju them sikurse u përcaktua në parashtrimet që
24 kam bërë unë - dhe unë e kisha parashtruar paraprakisht, dhe
25 në qoftë se ka pasur ndonjë paqartësi se cila është përgjigja

1 ime, unë dua t'ju them: pika që doja të ngrija unë është që
2 duhet të ketë një kanosje serioze për pengimin e një personi
3 serioz. Dhe termi duhet interpretuar në mënyrë të ngushtë. Dhe
4 neni 401(1) duhet të marrim fjalë për fjalë interpretimin në
5 qoftë se ka pasur tentativë, kjo mund të jetë evidencë e një
6 veprë penale tjetër sepse nuk synon drejtpërdrejtë një person
7 zyrtar. Por ajo që unë doja të ngrija dje, doja të thosha që
8 po, mund të ketë tentativë por nuk do të ishte në objektin e
9 nenit 401(1) dhe mbase nuk isha shumë i qartë dje. Kjo ishte
10 për sqarim për dje. Qëndrimi im, apo qëndrimi që kemi mbajtur
11 ne gjithmonë është tentativa në nenin 401(1) kërkon që të ketë
12 objekt, të jetë objektiv një person zyrtar, në mënyrë që të
13 shqyrtohen provat e përcaktuara në këtë dispozitë.

14 Tani, unë dje thashë që nuk ka prova dhe shpresoj që të
15 jem i qartë për këtë. Sa i takon shqetësimeve apo kritikave,
16 besoj se u bë edhe një koment edhe dje lidhur me përdorimin e
17 termit që kam bërë unë. Trajtimi i çështjes me shifra. Qasja
18 është e tillë. Çdo panel apeli duhet të shqyrtojë në radhë të
19 parë procesin, çdo aspekt të këtij procesi dhe jo vetëm t'i
20 referohet incidenteve specifike në procesin e zhvillimit
21 gjyqësor, por të shohë nëse procesi që i drejtë në tërësi dhe
22 në qoftë se dënimet janë të sigurt, pra janë të drejta.
23 Pozicioni ynë është që ka pasur disa raste kur procesi nuk
24 mund të konsiderohet i drejtë. Sigurisht, kjo ju takon ju, të
25 nderuar Gjykatës, ta shqyrtoni këtë në bazë të materialeve që

1 keni marrë, qoftë me shkrim apo qoftë me gojë, që kemi dhënë
2 sot edhe dje.

3 Tani sa i përket disa nga pikave që u ngritën nga ZPS-ja,
4 që ne ishte dhënë mundësia që t'i paraqisnim të gjitha provat,
5 kjo nuk është e vërtetë. Ne përmendëm faktin e nxjerrjes së
6 plotë të paketave dhe refuzimi për të thirrur dëshmitarët dhe
7 kufizimet e panevojshme që na u vendosën mbi dëshmitarët
8 ekspertë dhe ju, të nderuar Gjykatës, i njihni shumë mirë.

9 Nuk është e vërtetë që na është dhënë tërësisht
10 informacioni. Ne nuk patëm mundësi t'i kundërshtonim
11 materialet dhe nuk patëm mundësi të kundërshtonim provat që
12 paraqiti hetuesja e Prokurorisë, Znj. Pumper.

13 Prokuroria po ashtu tha se nuk ka prova për ndonjë
14 përfshirje në rrjedhjen e informacioneve. Nuk është e vërtetë.
15 z. Halling tha që nuk ka prova apo çfarëdo qoftë për nxitje
16 apo për detyrim. Unë nuk po trajtoj detyrimin sepse atë e
17 trajtoi z. Rees. Por kjo nuk është e saktë. Unë ua shpjegova.
18 Kjo nuk shpjegohet se si dolën dokumentet dhe burojnë nga ZPS-
19 ja, që është organi që tani ndjek penalisht dhe që po heton dy
20 apeluesit. Dhe kjo përcaktohet mirë në fakt, kemi shtjelluar
21 në paragrafin 140 të dosjes sonë të apelit. U bë deklaratë që
22 ZPS-ja punoi në mënyrë të drejtë. Domethënë kjo nuk është e
23 qartë nga provat. Në provat që ka paraqitur ZPS-ja edhe ekipet
24 e Mbrojtjes nuk pati një kalim -- pra nuk u shqyrtua siç duhet
25 ky aspekt. Kishim kërkuar detaje, kishim kërkuar -- deshëm të

1 dinim cilat ishin masat hetimore që ishin ndërmarrë për të
2 zbuluar cili qe burimi i rrjedhjes së informacioneve, si
3 mbërritën këto dokumente në ambientet e UÇK-së. Dhe asnjë nga
4 këto nuk mori përgjigje. Nuk ka ndonjë imazh filmik a është
5 intervistuar njeri në zonat rreth e rrotull dhe vetë apeluesit
6 kanë kërkuar që të vendosej zona në mbikëqyrje filmike, sepse
7 personi misterioz që kishte thënë që "unë do kthehem", mund të
8 zbulohen përmes mbikëqyrjes filmike. Por, asnjë nga këto
9 parashtrime nuk u mor seriozisht. Por kjo është shumë e
10 rëndësishme për këtë proces, ky aspekt: si arritën këto tre
11 paketa nga ZPS-ja në vendin që u gjendën. Pra konkretisht në
12 objektin, selinë e OVL UÇK-së.

13 Sa i takon paketës 2, thanë që kishte paketa minimale,
14 por në fakt na prezantuan vetëm gjashtë faqe të zeza, që në
15 fakt ishin shënuar dhe kjo u përmend edhe nga Gjykatësi Gaynor
16 gjatë procesit. Sot pamë një grafik nga ynë. Pumper, një
17 tabelë, pamë disa kolona, ku gjithçka është e fshirë, është e
18 mbuluar në të zezë.

19 Tani sa i takon çështjes së ligjit për klasifikimin, që
20 thuhet se nuk është përfshirë shprehimisht në ligjin e DHSK-së
21 dhe duhet ta përjashtojmë, por duhet të shohim fshehtësinë në
22 term të përgjithshëm. Tani, ndonëse ligji i DHSK-së nuk
23 shprehet për këtë çështje, atëherë ne duhet të shikojmë ligje
24 të tjera për interpretim, duhet t'ju referohemi ligjeve të
25 tjera.

1 Një nga pikat që është ngritur, dua t'i kthehem nëse
2 mundem një moment, sepse kjo lidhet me Pikën 5, konkretisht me
3 atë që deklaroi z. Halling, pikërisht, me diçka që tha z.
4 Halling sa i takon ligjit për klasifikimin. Pozicioni duhet të
5 jetë që interpretimi i Kodit Penal të Kosovës duhet të bazohet
6 në ligjet në totalitetin, pra, në tërësinë e ligjeve në fuqi
7 në Kosovë. Dhe meqë ligji për klasifikimin trajton kufizimin e
8 sekretit, ne nuk mund të përdorim një qasje të përgjithshme sa
9 i përket këtij kufizimi.

10 E kemi thënë qartësisht këtë, e kemi shprehur qartësisht
11 këtë në paragrafin 192 të dosjes sonë të apelit.

12 E di që kam kohë shumë të kufizuar kështu që po përpiqem
13 të flas pikat më të rëndësishme që kam mundësi.

14 Një nga komentet që është bërë lidhet me sinjalizuesit. E
15 di që z. Reese e trajtoi në fakt këtë, sa i takon çfarë është
16 deklaruar për opsionin bërthamor. Po pika e rëndësishme që
17 duhet vënë në dukje këtu është, sikurse tha edhe z. Reese, që
18 ishte pikërisht publikimi i drejtpërdrejtë i çështjeve që mund
19 ose mund të mos jenë objekt konfidencialiteti.

20 Kurse tani, të nderuar Gjykatës, nga provat e ekspertëve
21 të znj. Myers, si nga deklaratat që ka dhënë dhe nga provat që
22 ka paraqitur, për sa kohë janë marrë parasysh hapa të tjerë
23 dhe nuk kanë qenë të suksesshëm, atëherë ky opsion është ende
24 i pranueshëm dhe mbulohet nga Mbrojtja për sinjalizuesit. Por,
25 siç tha edhe z. Rees, apellesit nuk e publikuan këtë material,

1 nuk i kanë publikuar këto materiale. Ata ja vunë në
2 dispozicion mediave, por nuk i publikuan ata këto materiale,
3 dhe po ashtu siç do ta shikoni edhe nga vetë provat e z.
4 Haradinaj, z. Haradinaj gjatë kësaj periudhe ishte përpjekur
5 të ngrinte ato që ishin shqetësime legjitime sa i takon
6 procesit. Shqetësime legjitime që ai mendonte, e gjykonte këtë
7 një proces monoetnik dhe një proces të papërshtatshëm nga ana
8 e Prokurorisë, sepse supozoi që kishin bashkëpunuar me zyrtarë
9 serbë.

10 Tani unë do t'i përgjigjem çka tha Prokuroria më herët.
11 Në qoftë se kjo ishte vërtetë një çështje që doli dhe u shfaq
12 gjatë gjykimit. Nuk është çështja e bashkëpunimit pra, të
13 autoriteteve të Prokurorisë. Shumë individëve që besohet se
14 kanë qenë të përfshirë në bashkëpunim me ZPS-në, ishin
15 individë që kanë qenë të përfshirë, sipas z. Haradinaj kjo dhe
16 sipas shumë personave në Kosovë, kanë qenë të përfshirë
17 drejtpërdrejtë apo tërthorazi me kryerjen e tmerreve në Kosovë
18 gjatë konfliktit, këto shqetësime i ka ngritur për disa herë.
19 Nuk është kundërshtimi i tij, ai nuk kundërshton Prokurorinë.
20 Ai dëshiron që të gjithë personat që kanë qenë të përfshirë në
21 luftë të dënohen. Por, sa i takon provave të bashkëpunimit të
22 ZPS-së me zyrtarë që kanë qenë objekt i këtyre Njoftimeve të
23 Kuqe ndaj [e pakuptueshme], siç u paraqit në gjykim, kjo rriti
24 -- për atë ish-in shqetësime legjitime dhe ai mendonte që mund
25 t'i ngrinte këto shqetësime publikisht e privatisht, me

1 anëtarë të qeverisë, edhe në komunitetin ndërkombëtar. Por
2 asnjë nga këto përpjekje nuk qe e suksesshme. Prandaj kur
3 dokumentet ju paraqitën, pra ai bëri atë që ai gjykonte se
4 ishte në interesin publik dhe kjo është një çështje që është
5 mbështetur edhe nga dëshmitarët e Prokurorisë, siç përmendi
6 edhe z. Berisha.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Z. Cadman,
8 mendoj se tani duhet të mbyllnin fjalën tuaj.

9 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Patjetër.

10 Sa i përket dënimit, dëgjuam se z. Rees, por edhe unë e
11 prezantova dje dhe z. Rees përsëri e përmendi sot, sigurisht
12 ka pasur zhvillime në të drejtën penale ndërkombëtare dhe
13 është zhvilluar jurisprudenca me kohën, që ndihmon për të
14 kuptuar edhe ne parimet bazë, por çdo zhvillim duhet të jetë i
15 arsyeshëm përpjesëtimor, jo një dallim absolut nga ajo që
16 është normë dhe e pranueshme. Dhe në këtë kuptim, vendosja e
17 dënimeve të ashpra që nuk janë as të bazuara, sikurse tha z.
18 Whiting dhe as proporcionale, atëherë unë i kthehem
19 parashtrimet që bëra dje dhe u qëndroj të gjitha argumenteve
20 që janë parashtruar në dosjen e apelit dhe në përgjigjen që i
21 kemi dhënë Prokurorisë.

22 Të nderuar Gjykatës, ju uroj ta shqyrtoni apelin, ose të
23 shpallni të pafajshëm personat për të gjitha akuzat, ose
24 përndryshe do të bëhet një shkurtim i dënimit. Këto janë
25 parashtrimet e mia.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Para se t'i
2 jap fjalën zoti Gucati dhe z. Haradinaj, z. Ambos ka një
3 pyetje për Prokurorinë.

4 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Për z. Halling, pata një
5 shans të lexoja këtë gjykimin e EULEX-it, kodin e apelit të
6 EULEX-it, më falni, që është përgatitur nga dy gjykatës të
7 huaj dhe një gjykatës të Kosovës, ku saktësisht në këtë gjykim
8 e keni marrë ju përfundimin se s'është zbatuar dënim kumulativ
9 apo Blockburge.

10 GJYKATËSI HALLING: [Përkthim] Janë paragrafët 28, 29.
11 Nëse lexoni paragrafin 28, 29 të gjykimit që keni përpara,
12 Paneli i Apelit flet për dënimin kumulativ. Pra flitet për
13 çështjen -- për konceptimin fillimisht, thuhet që nuk thuhet
14 shprehimisht ky parim dhe nuk jep doktrinën apo rregullën
15 specifike.

16 Por thotë që kriminelët -- tribunalët ndërkombëtarë
17 penalë duhet të kenë një standard dhe marrin disa çështje nga
18 TPNI-ja dhe nga disa gjykata të tjera ndërkombëtare dhe
19 paragrafi thotë "Paneli i Apelit ndjek, zbaton këtë qasje
20 ligjore" që edhe kjo është shprehimisht në Nenin 29.

21 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Faleminderit. Shumë e
22 dobishme. Sa i takon nenit 71, që është i njëjti formulim si
23 neni 76 i vitit 2019 që është edhe Kodi relevant për ne. Si e
24 interpretoni ju formulimin "me një ose më shumë veprime", dhe
25 kështu me radhë? Disa vepra të ndryshme penale, krahasuar, për

1 shembull me Kodin Penal Francez apo Kodin Penal Gjerman, si
2 krahasohen ato me këto kode penale?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Po e marr për të mirëqenë që ju e
4 njihni më mirë se unë Kodin Penal gjerman, atëherë. Por, kur
5 flasim për akte të shumta, sipas këtyre dispozitave, nuk është
6 specifike se çfarë tradite ligjore sugjeron gjuha apo
7 formulimi që është përdorur dhe këtë po shoh me autoritete
8 kosovare. Nuk po marrin qasje të njehsuar ndaj edhe vetë
9 gjykatat e tyre to apelit s'kanë një qasje të njehsuar dhe kjo
10 lë hapësirë për interpretim dhe paneli i apelit e ka
11 interpretuar përmes një standardi që është i mirë, pranuar në
12 shumë vende dhe që ne mendojmë që përshtatet edhe në rastin
13 tonë.

14 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Pyetja ime e fundit. Më falni
15 që po këmbëngul por jam vërtetë i interesuar sepse po mësoj
16 nga pikëpamjet tuaja: a është e rëndësishme vërtetë që të kemi
17 një gjykim të EULEX-it ose do ta them ndryshe pyetjen: a do të
18 ishte më bindës po të ishte një gjykatë autonome në Kosovë në
19 këtë gjykim? A bën dallim për ju kjo gjë? Kemi një gjykatë me
20 tre gjykatës atje, dy syresh kanë qenë të huaj?

21 Z. HALLING: [Përkthim] Personalisht do të thosha jo,
22 sepse ligji që është zbatuar është i njëjti. Është i njëjti
23 ligj, në fakt që zbaton edhe Dhoma e Specializuar e Kosovës
24 dhe nuk mendoj që gjykatësit e kësaj gjykate po japin ato
25 gjykime që janë më pak të rëndësishme apo më pak të vlefshme

1 për shkak të kombësisë së gjykatësve që ishin ulur në palën.

2 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Faleminderit.

3 Z. REES: [Përkthim] Dua të shtoj diçka sepse z. Halling
4 në fakt nuk pati shans të bënte parashtrimet e tij lidhur me
5 këtë përgjigje. Ky burim, kjo jurisprudencë nuk është
6 jurisprudencë në vetvete që demonstroi se një dënim qoftë me
7 nenin 401(1) dhe 401(2) mund të qëndrojë për të njëjtën
8 aktakuzë.

9 Në këtë rast, K.P. u gjykua nga paneli sipas nenit 33.
10 Vendimi i gjykatës së apelit ishte i atillë që në fakt nuk
11 duhet të ishte dënuar për këtë veprë penale, dhe e ndryshuan
12 në fakt dënimin, duke e zëvendësuar dënimin për çështjen e
13 shpërdorimit të detyrës zyrtare, dhe nxorën vendimin pastaj,
14 në bazë të Nenit 446. Pra, në këtë çështje Prokuroria kërkoi
15 dënim për të dyja akuzat dhe edhe Paneli i Apelit edhe Trupi
16 Gjykses nuk ranë dakord. Ne thamë që të japim dënim vetëm për
17 një nga veprat penale, nuk u pajtuam për cilën veprë penale
18 dhe Paneli i Apelit në të vërtetë e prapësoi dënimin për
19 shpërdorim të detyrës zyrtare dhe e zëvendësoi me dënimin për
20 nxjerrjen e një vendimi gjyqësor të pa saktë, të gabuar, sepse
21 Trupi Gjykses kishte dhënë një dënim për veprën penale më të
22 rëndë nga të dyja por e kishte bërë këtë në rrethana kur
23 mendoi -- nuk janë kontraversiale, nuk janë të diskutueshme.

24 Tani askush nuk mund të thotë që t'i marrim parasysh të
25 dyja dënimet, t'i japim të dyja dënimet, sepse i pandehuri

1 K.P.-ja kishte dy akuza për të njëjtën sjellje, për të njëjtin
2 veprim. Dhe ata thanë: për hir të kësaj çështjeje, nuk ishte
3 dallim material të elementëve të shpërdorimit të detyrës
4 zyrtare, apo nxjerrjes së vendimit gjyqësor të pa saktë. Pra,
5 nuk mund të dënohej ky i pandehur për të dyja akuzat që ishin
6 ngritur për të.

7 Por fakti se kur një person nuk mund të dënohet për dy
8 vepra penale, për të cilat nuk ka dallim materiale, për të
9 njëjtën sjellje tani ky është një propozim që është jo-
10 kontraversal, po në vetvete ky nuk është jurisprudencë, kjo
11 nuk është bazë ligjore, që të mund të dënohesh edhe për veprën
12 penale sipas nenit 401(1) dhe 401(2) në të njëjtën kohë.

13 Siç e kemi thënë në dosjen tonë të apelit, në
14 kundërpërgjigjen tonë, më saktë, përcaktimi i dallimit
15 material në elementet e veprës penale është vetëm një kriter
16 minimal në mënyrë që ju të shihni nëse është e justifikueshme
17 dhe në qoftë se është e qëndrueshme për dënimin për të dyja
18 veprat penale, për të njëjtën sjellje dhe kjo nuk është e
19 mjaftueshme. Dhe prandaj ne po themi, kjo bazë ligjore në
20 fakt, nuk mund të merret si bazë.

21 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Kam një pyetje. Ju përmendni
22 -- ju e ngrini këtë në paragrafin 26, në një poshtëshënim
23 konkretisht, është një gjykim i Gjykatës së Pejës. A është kjo
24 gjykatë e shkallës së parë? A është kjo një gjykatë -- pra
25 gjykata e shkallës së parë zbatoi atë që e kishte kthyer

1 gjykata e apelit.

2 Z. REES: [Përkthim] Në fakt mund ta gjej unë përgjigjen e
3 kësaj. Unë s'e di përgjigjen tani por ne mund ta gjejmë bazën
4 ligjore t'ja dërgojmë Panelit.

5 GJYKATËSI AMBOS: [Përkthim] Do të na shërbente shumë në
6 qoftë se do të kishim vendimin që ka nxjerrë gjykata e
7 shkallës së parë.

8 Z. REES: [Përkthim] Siç nuk mund ta konfirmojmë, por i
9 jam shumë mirënjohës kolegut Halilaj nga përvoja që ka nga
10 gjykatat e Kosovës. Është fjala për një çështje të EULEX-it
11 përpara gjykatave kosovare. Gjykata Themelore e Pejës përbëhet
12 nga gjykatës së Kosovës dhe të EULEX-it, pra janë dy lloje
13 gjykatash.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Mbase
15 përgjigjen mund ta marrim më vonë.

16 Z. HALLING: [Përkthim] Po, sapo ta marrim, do t'ua
17 dërgojmë.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Tani ja jap
19 fjalën në qoftë se dëshiron, z. Gucati. Nëse dëshiron të thotë
20 diçka, të bëjë ndonjë deklaratë. Keni dhjetë minuta.

21 APELUESI GUCATI: Po, faleminderit shumë.

22 Të nderuar Gjyqtarë, të nderuar të pranishëm në sallë, të
23 nderuar dy zonjat e nderueme përfaqësuese të ambasadës të
24 shtetit tim. Me këtë rast dëshiroj t'i them disa fjalë. Unë
25 jam një qytetar i Republikës së Kosovës, jam shumë krenar ku

1 ne si shtet jemi sot dhe jemi me plotë shpresë se çfarë mund
2 të bëhemi në të ardhmen. Është e ardhmja e të gjithë
3 qytetarëve të Kosovës, ajo që më motivon. Mua si luftëtar i
4 lirisë, si invalid i luftës çlirimtare, fort i krejt
5 rastësisht më ka mbajtur në jetë. Thuhet se rasti është mbreti
6 i botës. Kësaj thënie i besoj në plotëni, pasi vërtetë është
7 mrekulli. E shfrytëzoj këtë mundësi të them se me burgosjen
8 time Prokuroria e Dhomave të Specializuara ka shkelur të
9 gjitha të drejtat dhe liritë e mia njerëzore. Populli im me
10 dekada i është imponuar lufta për liri dhe çlirim. Populli e
11 as unë, si pjesëtar i tij, nuk e kemi dashur dhe as zell
12 lufte, sepse ne kemi qenë dhe jemi të bindur se të kërkosh
13 luftë është çmenduri, por t'i përgjigjesh asaj, kur të
14 imponohet, siç na është imponuar neve, është urti dhe mençuri.

15 Shteti i Kosovës asnjëherë nuk ka qenë agresor ndaj asnjë
16 shteti. Ne duhet ta kemi të drejtën të mbrohemi vetë, veten
17 tonë, kundër atyre që e kundërshtojnë të drejtën tonë. Për të
18 jetuar në paqe, të gjitha shtetet duhet të lenë të drejtën të
19 mbrojnë veten e tyre ndaj agresorit.

20 Unë jam krenar për të gjithë bashkëluftëtarët e mi. Unë
21 dhe bashkëkombësit e mi aktualisht gjendemi në burgun e
22 sigurisë së lartë në Schevelingen. Kemi qenë dhe jemi të
23 bindur se me asnjë të drejtë evropiane apo ndërkombëtare nuk
24 mohohet e as nuk dënohet lufta për liri dhe jetë. Ne kemi qenë
25 të shtrënguar të luftojmë kundërt një shteti që me program dhe

1 me projekt është angazhuar për shuarjen e popullit tim. Kemi
2 luftuar kundër një shteti që shumë herë më parë dhe me luftën
3 e fundit ka kryer krime dhe gjenocid. Këto krime janë parë nga
4 bota e cila ka intervenuar me bombardimet e NATO-s plot 78
5 ditë, për ta ndaluar gjenocidin Serb.

6 Të gjithë që i kemi luftuar ato politika, në asnjë mënyrë
7 nuk e kemi rrezikuar jetën ndonjë civili të asnjë etnie, as sa
8 e kemi rrezikuar jetën tonë e të familjeve tona. Dëshmia më e
9 mirë e kësaj lufte është se Serbia kundër familjes së
10 komandantit legjendar Adem Jasharit në fshatin Prekaz të
11 Drenicës njerëzit e tillë meritojnë falënderimin, mirënjohjen,
12 e jo të akuzohen me gënjeshtër të Serbisë gjenocidiale.

13 Ne si drejtues të OVL UÇK-së të Ushtrisë Çlirimtare të
14 Kosovës, nuk kemi bërë asnjë faj të vetëm dhe nuk e kemi
15 shkelur ligjin. Janë të tjerët pa asnjë ndikimin tonë që në
16 zyrat tona i kanë sjellë dokumentet e Prokurorisë së Dhomave
17 të Specializuara. Ne i kemi lajmëruar organet kompetente në
18 atë që kishte ndodhur, por lidhur me ata njerëz, askush nuk e
19 ka bërë hetim. As sot e kësaj dite.

20 Prandaj, ne nuk kemi asnjë faj për këto rrjedhje. Duke u
21 nisur nga kjo që thashë, kërkoj nga ky Trup Gjyqësor që të na
22 lirojë nga të gjitha akuzat pasi ne nuk kemi merituar asnjë
23 ditë të vetëm në burg. Ne presim vetëm lirimin tonë, përfund,
24 për respekt për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe për
25 popullin tim.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

2 Faleminderit, zoti Gucati --

3 APELUESI GUCATI: Po. Dëshiroj që të minutat e mia, ato
4 minuta që kanë ngelur, t'ja kaloj z. Nasim Haradinaj.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Me sa
6 duket, të gjithë duan të përdorin minutat e të tjerëve.
7 Megjithatë, e kemi kaluar afatin tashmë.

8 Z. Haradinaj, ju lutem.

9 APELUESI HARADINAJ: Jo, znj. Gjyqtare, unë besoj se ky po
10 do të më bëjë një kompensim të vogël ndaj mbrojtjes time.
11 Kështu që unë do të vazhdoj. Besoj se e kryej, por nëse ka
12 nevojë për në minutë ose dy.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Jo, jo,
14 keni kohë mund të flisni.

15 APELUESI HARADINAJ: Ju faleminderit.

16 Të nderuar Gjyqtarë të Apelit, të nderuar avokatë dhe ju
17 të pranishëm, të nderuar përfaqësues të vendit tim. Kaluan mbi
18 dy vite dhe saga që u mundua krye Prokurori i kësaj Prokurorie
19 me bashkëautorët e tij, ku bashkëpunëtorë të ngushtë pati edhe
20 zbatuesit e urdhrave të Milosheviçit, siç janë Vukçeviç e të
21 tjerë, së bashku edhe me drejtoritë e shërbimeve sekrete
22 serbe, si Sorza, VOA e BIA, me përgjegjësin për Kosovën Bojan
23 Dimiç, dhe këlyshët e tij shqiptarë, të cilët me mediat tona
24 disa flasin qoftë si gazetarë, qoftë si analistë të
25 konsiparcioneve, e disa matrapazë të tjerë shkojnë aq larg sa

1 hiqen edhe si analistë e koordinatorë të CIA-s për Evropën dhe
2 Azisë dhe shfrytëzojnë tragjeditë e të tjerëve dhe kanë
3 arritur t'i manipulojnë edhe disa familje të tyre vetëm e
4 vetëm që paraqiten si njerëz të konspiracioneve të mëdha, duke
5 përfituar edhe materialisht. Dihet mirë se Serbia nuk është se
6 në [e pakuptueshme], vetëm ta errësojë luftën e drejtë të
7 Kosovës për liri.

8 Më vjen keq që duhet të them, por gjatë gjithë këtij
9 procesi deri në ditën e sotme, unë vetë si jurist kam parë
10 tendenca nga Prokuroria për t'i bërë bisht të vërtetës, dhe
11 ikje nga përgjegjësia, duke u munduar t'i fshehë gabimet dhe
12 mungesat e profesionalizmit të tyre. Nuk ka profesionalizëm
13 aty ku gënjeshttrat dhe montimet apo justifikimet janë si
14 qëllim. Pra duke krijuar viktimën apo viktima të rrejshme,
15 duke dashur -- do të arrijë këto efekte. E para, duke ikur
16 përgjegjësisë për rrjedhjen e dokumenteve nga zyrat e kësaj
17 Prokurorie, dhe së dyti, të arrijnë qëllimin për frikësimin e
18 njerëzve në Kosovë, pra të shtypë guximin qytetar, dhe të
19 mohojë të drejtën e tyre themelore dhe të garantuar me ligje
20 ndërkombëtare, si ai për të drejtën dhe lirinë e shprehjes dhe
21 të drejtën e interesit publik por edhe të sinjalizuesit.
22 Orvatja e kësaj Prokurorie ku përpos prokurorëve edhe vetë
23 Kryeprokurorit Smith, shkoi aq larg për ne deri në fyerjen dhe
24 të vetë Trupit Gjykses, duke qitur për akte të kryer ku ajo
25 personalisht na shpalli të fajshëm, duke mos marr fare

1 parasysh të drejtën tonë të prezumimit të pafajësisë që ende
2 vlente. Pasi konstatoi këtë, ajo me Trupin Gjykses foli vetëm
3 për pjesën e dënimit. Në këtë sallë gjatë gjithë këtij procesi
4 Prokuroria dhe Kryetari i Trupit Gjykses, aktruan, "betejën
5 heroike me armikun e vërtetë"

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Z.
7 Haradinaj, po flisni shumë shpejtë nuk ju kapim dot.

8 APELUESI HARADINAJ: Znj. Gjykatëse, më falni, po mundohem
9 më ngadalë. Me lejen tuaj.

10 Pra po filloj: në këtë sallë, gjatë gjithë këtij procesi,
11 Prokuroria dhe Kryetari i Trupit Gjykses, aktruan, "betejën
12 heroike me armikun e vërtetë", ekzakt atë betejë që shpjegon
13 Servantesi në librin e Don Kishotit dhe Panco Villas kundër
14 mullinjve të erës.

15 Duke marrë parasysh këtë, edhe fundi i seancës, në
16 vendimet që morri ishte i tillë. Aty vazhdimisht ne dhe
17 mbrojtësit tanë na u mohuan e drejta e barazisë për betejën.
18 Mjafton të lexohet me vëmendje transkriptimi i atij procesi
19 dhe do të bindeni. Po le ta lemë këtë më një anë. Sepse
20 ndoshta edhe Trupi Gjykses nuk ka dashur, apo ta them troç,
21 nuk ka guxuar ta shprovojë kredibilitetin e tij profesional.
22 Ndoshta pse kontrata e punës i kanë të tilla. Ai Trup Gjykses
23 haptazi ishte palë me Prokurorinë dhe gatuante brumin për në
24 vendim të tillë arbitrar. Vërej qëllimi që ishte që apriori të
25 dënohemi ne.

1 Pasi që ishte thënë qysh herët fill pas arrestimit tonë,
2 pra, ne në një konferencë ambasadorësh, është thënë se jemi
3 fajtorë. Atëherë ju, Trupi Gjykues, ka qenë e detyruar që
4 dënimin ta bëjë fakt të kryer, sepse për hesapet e ZPS-së,
5 është dashur një vendim i tillë. Prandaj jam i bindur se ky
6 proces është kryer sipas porosisë duke pasur forcën e
7 njëanshmërisë dhe të drejtën e mos dhënies llogari askujt.

8 Unë në jetën time kësaj gjykimesh të porositura i kam
9 përjetuar në vitet 80' në ish-Jugosllavi komuniste. Unë jam
10 treguar shumë i singertë dhe asnjëherë nuk i kam fshehur
11 mendimet e mia personale për këtë lloj Prokurorie dhe kjo
12 është një e drejtë e imja, qoftë dhe nëse mund të jetë ndonjë
13 paragjykim, por po ua them se të gjitha ato që kam menduar për
14 këtë Prokurori më parë deri në ditën e arrestimit, e duke ja
15 shtuar edhe atë që kam thënë dhe gjatë proceseve gjyqësore, me
16 veprimet që kjo Prokurori ka bërë dhe po vazhdon t'i bëjë
17 gjatë gjithë kësaj kohe sa jam këtu, arriti që të m'i
18 vërtetojë pikë për pikë ato që unë kam thënë për të.

19 Nëse ky proces përfundon qoftë edhe me rrëzimin e plotë
20 të aktakuzës, dhe mbyllet si rast, prapë mendoj se procesi nuk
21 ka përfundim të drejtë nëse nuk zbardhet e vërteta në tërësi.
22 Unë ende jam i bindur në veten time se as vetë Trupi Gjykues,
23 as ne as Mbrojtja dhe as ju, anëtarët e panelit, nuk e keni të
24 zbardhur se si erdhën gjërat deri këtu. Prokurorisë nuk po i
25 them kështu, se ajo po duket haptazi se nuk ka interes. Pra

1 unë dhe Organizata e OVL-së së UÇK-së nuk i frigohe
2 drejtësisë dhe kërkojmë të shkohet deri në fund e të mos mbesë
3 kjo ngjarje si mister. E për t'u bërë kjo, duhet të sqarohen
4 për të gjithë ne së pari se nga rrodhën ato dokumente. Së
5 dyti, si dhe kush e nxori tërë atë dokumentacion. Kush i solli
6 ato dokumente në Kosovë dhe kush i pranoi ato dokumente?

7 Kush na i solli ne në zyrë? Nuk po pyes qëllimin, se pse.
8 Ajo u pa qartë këtu gjatë këtyre viteve.

9 Pika e gjashtë, nëse ai personi është marrë vesh me dikë
10 prej nesh, cili është ai person? Unë dhe Hysniu sigurisht që
11 nuk jemi. Pika e shtatë, pse inspektorët e ZPS-së nuk u
12 treguan asnjëherë të gatshëm për të kapur ata njerëz? Oficerët
13 vazhdimisht, për të tre rastet, i kishin të dhënat. Bile edhe
14 videofilmimet nga kamerat tona të sigurisë, të cilat filmime
15 vetëm pas insistimit këmbëngulës dhe të vazhdueshëm tonin --

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Më ngadalë
17 ju lutem.

18 APELUESI HARADINAJ: Pika shtatë, pse inspektorët e ZPS-së
19 nuk u treguan asnjëherë të gatshëm për t'i kapur ata njerëz.
20 Oficerët vazhdimisht, për të tre rastet, i kishin të dhënat.
21 Bile edhe video filmimet nga kamerat tona të sigurisë, të
22 cilat filmime vetëm pas insistimit këmbëngulës të vazhdueshëm
23 tonin, kanë pranuar t'i marrin. Pse pra, ky hezitimi e
24 neglizhencë e Prokurorisë? Tre pikë arbitrore.

25 Pika tetë, nëse ai material është aq konfidencial, pse

1 ende edhe në ditën e sotme janë stoqet e pa marra nga mediat e
2 ndryshme. Ato ende janë aty, për kundër dijenisë që ka kjo
3 ZPS. Shumë pikëpyetje, shumë pikë çuditëse.

4 Pika nëntë, pse ne vazhdimisht na është stopuar t'i
5 përmendim njerëzit. Seanca që para arrestimit tonë, ata njerëz
6 janë publikë, të njohur mediatikisht edhe personalisht flasin
7 e deklarohen edhe sot e kësaj çdo dite, gati çdo javë. Pikë
8 çuditëse dhe pikë pyetje.

9 Pika dhjetë. A është e sigurt se ato kanë mbërritur vetëm
10 te ne? Dhe që është më me rëndësi, në cilën kohë u nxorën, dhe
11 në cilën ato mbërritën është Kosovë. Prandaj z. Halling [e
12 pakuptueshme] e pranoni se eprori juaj Whiting pak më përpara
13 tha një gënjeshtër të madhe, që nuk ka pikëpyetje. Këtu ka
14 shumë pikëpyetje e disa pika çuditëse.

15 Ne duam patjetër të zbardhet këtu, sepse kur të zbardhen,
16 ne personalisht ne nuk na lidh asgjë me kryerësit e kësaj
17 veprë. Andaj ne duhet të lirohemi tërësisht nga aktakuza dhe
18 Prokurori të kërkojë falje për sjelljet abuzive, poshtëruese,
19 të pa [e pakuptueshme] dhe të pa justifikuara në baza juridike
20 e njerëzore. Është krejt normale që ta di edhe opinionimi publik
21 e ndërkombëtar, si dhe ai i Kosovës. Them "duhet", sepse tani
22 është zhvilluar një proces gjyqësor dhe keni marrë një vendim
23 që nuk besoj që ka ndodhur në ndonjë rast tjetër të tillë,
24 aspak të argumentuar në ndonjë gjykatë ndërkombëtare apo
25 nacionale në vendet e demokracisë liberale.

1 Ky procesi si i tillë do jetë shembulli më tipik i një
2 Prokurorie politike dhe fyese për vetë drejtësinë në këtë
3 shekull të ri, por edhe një shembull tipik se si nuk duhet të
4 bëhet drejtësia.

5 Të nderuar Trupi i Apelit, po e them hipotetikusht, se ne
6 nuk do e lajmëronim se çfarë na ka ardhur, apo fare nuk do të
7 merreshim me to, e thjesht do ta zhdukim materialin. Cila do
8 të ishte dobia e saj? A do të ndryshonin rrjedhën e
9 gënjeshtreve strategjike të Millosheviçit? Pra kjo ishte me i
10 shkue përshtat pikërisht atyre dhe këtyre që nuk po duan që të
11 zbardhin rastin. Pra, ne ishim në pozicionin e aktit -- para
12 aktit të kryer. Përndryshe kjo Prokurori po mendon që në emër
13 të drejtësisë të qërojë hesapet me një etni të caktuar, të
14 përqëllimshëm, sipas kandarit të Serbisë, pra duke e
15 anashkaluar atë dhe relativizuar krimet barbare të një regjimi
16 gjenodicial, i cili ka bërë katër luftëra në territorin e ish-
17 Jugosllavisë. Prandaj, fuqishëm besoj se ne kemi kryer detyrën
18 më të devotshme si qytetarë të Kosovës, në aspektin e
19 interesit publik, por edhe të atij ndërkombëtar, ku duke
20 sinjalizuar për rrjedhjet e pakuptimta nga kjo Prokurori, e ku
21 sipas mediave, ne kemi informuar edhe zyrat e ZPS-së, dhe
22 hetuesit e tyre në Kosovë, duke e ruajtur edhe një kopje për
23 ta.

24 ZPS-ja i dha vetes afat 24 orësh për të marrë atë
25 material sepse nuk u ngut ai, t'i marri më herët, pra para se

1 të ndërhyenin mediat. Hetueseve të tyre u mjaftonin 12 minuta
2 të arrinin në zyrat tona, ndërsa për mediat ishte dhënë afati
3 1 deri në 3 orë. Ne nuk kemi kryer asnjë veprim tjetër përpos
4 që kemi lajmëruar përmes faqes sonë zyrtare mediat dhe dy
5 Prokuroritë: atë të Kosovës dhe njëkohësisht edhe oficerët e
6 SPO-së. Atyre u tregonim edhe porosinë që linte dërguesi,
7 gjatë prurjes së dokumenteve. Unë kurrë as për një herë të
8 vetme nuk kam kërcënuar apo thirrur dikë personalisht, as me
9 telefon, as me gojë, as me app-et e ndryshme telefonike dhe
10 këtë mund ta verifikoni. Ne asnjëherë nuk kemi bërë kopjime të
11 këtyre letrave. Krejt çka kemi bërë ne, kemi bërë ato që kemi
12 thënë më herët. Pra, kemi lëvizur dokumentet në një distancë
13 prej 20 metrash, brenda objektit tonë dhe duke menduar se më
14 së miri dhe më me profesionalizëm mund t'i trajtojnë vetëm
15 mediat, prandaj edhe ju drejtuam atyre. Pra ishte tërësisht në
16 vullnetin e tyre se çfarë do të bënin. Dhe për fund, ne
17 kërkojmë që ju të bëni zbardhjen kompletë të kësaj ngjarjeje -
18 -

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Z.

20 Haradinaj, duhet ta mbyllni.

21 APELUESI HARADINAJ: Dhe për fund, ne kërkojmë nga ju
22 zbardhej komplet të kësaj ngjarjeje dhe presim vetëm të
23 vërtetën, sepse nëse ajo zbardhet, ka drejtësi. Pra nga ju
24 kërkojmë drejtësi pa paragjykitime, pa anime, dhe nuanca
25 politike. Ju faleminderit për durimin.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

2 Faleminderit, z. Haradinaj.

3 Doni të ngrini edhe një çështje tjetër?

4 Z. CADMAN: [Përkthim][Përmes videolidhjes] Nuk kam ndonjë
5 argument, por thjesht për të ngritur një çështje me ju dhe për
6 t'ju informuar se sot pasdite do t'ju paraqesim një parashtrim
7 të protokolluar konfidencial. Informacionin e kemi mësuar
8 gjatë 24 orëve të fundit dhe për këtë duam të bëjmë një
9 parashtrim konfidencial. Lidhet me çështje për të cilat keni
10 dhënë vendim. Po e bëjmë kaq vonë sepse sapo na erdhi një
11 material i tillë.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Nuk e dimë
13 këtë parashtrim, nuk e dimë për çfarë është ky parashtrim i ri
14 por e mbajtmë shënim dhe do ta shohim gjatë pasdites.

15 Me këto fjalë përfundon edhe seanca e apelit.

16 Përpara se ta mbyllim, dua të falënderoj palët, dhe Zyrën
17 Administrative për punën e tyre për pjesëmarrjen e tyre. Dua
18 gjithashtu t'i shpreh mirënjohjen ekipit ligjor, të
19 përkthyesve, stenografëve, teknikëve audio-vizualë dhe
20 personelit të sigurisë për asistencën e tyre të shkëlqyer.

21 Në momentin e duhur do të japim edhe ne gjykimin, dhe
22 tani përfundojmë.

23 --- Seanca mbyllet në orën 13.10

24

25